DOKUMENT POLITIKASH

# REAGIMI I QEVERIVE VENDORE NDAJ EMERGJENCËS SË COVID-19 NË SHQIPËRI: JANAR 2020- PRILL 2020

Përgatitur nga:

Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit | **Rudina Toto, Merita Toska, Dritan Shutina**

Shoqata për Autonominë Vendore | **Adelina Farrici, Alisa Limaj**

Resilience Series

*18 qershor 2020*

## Tabela e përmbajtjes

Shkurtesa.....5
Përmbledhje.....6
Sfondi.....7
1. Metodologjia e anketimit dhe struktura e dokumentit të politikës.....11
2. Reagimi i Qeverive Vendore në Shqipëri gjatë emergjencës së COVID-19 - gjetjet e anketimit të përgjithshëm.....13
2.1 Reagimi në nivel bashkie ndaj emergjencës.....14
2.2 Komunikimi dhe bashkëpunimi me qytetarët dhe palët e tjera të interesit.....16
2.3 Reagimi në nivel bashkie: masat dhe veprimet e ndërmarra dhe/ose të mbështetura në nivel vendor.....24
2.4 Sfidat: shërbimet, financat, cenueshmëria dhe efektet socio-ekonomike.....28
2.5 Nevojat në të ardhmen.....36
3. Diskutimi i gjetjeve.....40
3.1 Qeverisja shumënivelëshe.....40
3.2 Reagimi në nivel vendor kundrejt faktorëve territorialë.....45
4. Përfundime dhe Rekomandime.....55
4.1 Përfundime.....55
4.2 Rekomandime.....58
5. Shtojcat.....61
5.1 Pyetësori.....61
5.2 Nevojat e qeverive vendore.....70
Referenca.....73

## Tabela e figurave

Figura 1. Bashkitë që morën pjesë në anketim (majtas); raste/10,000 banorë, 3 qershor 2020 (djathtas).....13
Figura 2. Vullnetarët që ofruan asistencë në bashki gjatë krizës së COVID-19.....23
Figura 3. Shpërndarja e pakove ushqimore sipas njësive administrative.....26
Figura 4. Rastet e infektuara për 10,000 banorë në nivel vendor (pa përfshirë humbjet e jetës), data kufi 3 qershor 2020 (majtas) dhe dendësia e popullsisë në banorë për km2 për bashki (djathtas).....47
Figura 5. Infektimet në total (majtas) dhe të infektuarit/10,000 banorë (djathtas) në nivel qarku, 11 qershor, 2020.....50
Figura 6. PBB-ja e qarkut për frymë (majtas, 2017, Euro) dhe numri i ndërmarrjeve për 1000 banorë në nivel qarku 2018 (djathtas).....52
Figura 7. Punësimi (%, majtas) dhe Papunësia (%, djathtas) në nivel qarku, 2019.....53
Figura 8. Shtretërit në spitale për 10,000 banorë, 2016 (majtas); sasia e ujit të prodhuar për person të furnizuar, 2017 (m3) (djathtas).....54

## Tabela e grafikëve

Grafiku 1. Shpërndarja e rasteve pozitive sipas bashkive.....15
Grafiku 2. Intensiteti i komunikimeve me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (numri i komunikimeve, tema e të cilave është zgjedhur nga bashkitë).....18
Grafiku 3. Intensiteti i komunikimeve me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (numri i komunikimeve, tema e të cilave është zgjedhur nga bashkitë).....20
Grafiku 4. Intensiteti i komunikimeve me aktorë të tjerë (numri i komunikimeve, tema e të cilave është zgjedhur nga bashkitë).....20
Grafiku 5. Dezinfektimi i hapësirave dhe objekteve publike.....25
Grafiku 6. Kohëzgjatja (majtas) dhe frekuenca e shpërndarjes së pakove ushqimore (djathtas).....27
Grafiku 7. Përqindja e bashkive që e zbatuan më shumë se një herë dërgimin e pakove ushqimore për familjet e mbështetura.....27
Grafiku 8. Përqindja e bashkive që hasën vështirësi në shpërndarjen e pakove ushqimore për kategoritë në nevojë.....28
Grafiku 9. Vlerësimi i sfidave në shpërndarjen e pakove ushqimore.....29
Grafiku 10. Numri i bashkive të anketuara që u përballën me sfida në lidhje me ofrimin e shërbimeve gjatë COVID-19.....29
Grafiku 11. Norma e pritshme e mbledhjes së të ardhurave nga burimet e veta kundrejt planit, gjatë katër muajve të parë të 2020-s.....31
Grafiku 12. Bashkitë (%) që priten të hasin probleme në mbledhjen e të ardhurave nga burimet e veta.....32
Grafiku 13. Faktorët që pengojnë shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore nga familjet.....33
Grafiku 14. Faktorët që pengojnë shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore nga bizneset.....33
Grafiku 15. Sfida të tjera afatshkurtra [për t'u] hasur nga bashkitë.....34
Grafiku 16. Vlerësimi i sfidave nga shkalla 1- më e rëndësishmja deri te shkalla 5- më pak e rëndësishmja (frekuenca e çdo sfide bazuar në vlerësimin e bashkive).....36
Grafiku 17. Nevojat e qeverive vendore në të ardhmen afatshkurtër deri afatmesme.....38
Grafiku 18. Bashkitë (% ndaj QV-ve të anketuara në total) që përzgjedhin secilën prej kategorive të nevojave.....39
Grafiku 19. Rastet e infektuara për 10,000 banorë në nivel vendor (pa përfshirë vdekjet), data kufi 3 qershor 2020.....46
Grafiku 20. Shpërndarja e popullsisë vendase sipas lartësive mbi nivelin e detit.....48
Grafiku 21. Ndërmarrjet në nivel vendor për lloj 2018.....49
Grafiku 22. Migrimi përgjatë viteve (majtas) dhe ndryshimi i popullsisë për qark (në hyrje dhe dalje, djathtas).....51

## Tabela e tabelave

Tabela 1. Komunikime me institucione të tjera.....17
Tabela 2. Ndikimi financiar i COVID-19 te financat nënkombëtare.....43
Tabela 3. Nevojat e bashkive 2020-2021.....70

## Shkurtesa

| | |
|---|---|
| ALL | Lek shqiptar |
| ASIG | Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor |
| AMVV | Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore |
| COVID | Sëmundja e Koronavirusit |
| OSHC | Organizatat e Shoqërisë Civile |
| ZRF | Zvogëlimi i Riskut të Fatkeqësive |
| PPB | Prodhimi i Brendshëm Bruto |
| TNI | Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë |
| INSTAT | Instituti i Statistikave të Shqipërisë |
| QV | Qeveri Vendore |
| MFE | Ministria e Financave dhe Ekonomisë |
| MSHMS | Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale |
| AKMC | Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile |
| OJF | Organizatë Jofitimprurëse |
| OECD | Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik |
| OSHE | Operatori i Shpërndarjes së Energjisë |
| KM | Kryeministria |
| TAP | Taksa mbi të Ardhurat Personale |
| TPP | Taksa mbi Pasurinë e Paluajtshme |
| SHAV | Shoqata për Autonominë Vendore |
| SPSS | Paketa Statistikore për Shkencat Sociale |

## Përmbledhje

Ky dokument politikash synon të dokumentojë reagimin[1] e qeverive vendore në Shqipëri ndaj emergjencës së COVID-19, duke u fokusuar te periudha përpara shpërthimit të pandemisë (janar-shkurt 2020) dhe periudha e izolimit (mars-prill 2020).

COVID-19, me më shumë se 8 milion raste të konfirmuara në mbarë botën, me më tepër se 440,000 vdekje dhe me një kurbë që sa vjen e rritet, mbetet një prej pandemive më të rëndësishme të shekullit të 21-të.[2] Shpërthimi i COVID-19, ndonëse u shpalos si emergjencë shëndetësore, ka pasur dhe do të vijojë të ketë pasoja të rënda afatshkurtra deri afatgjatë socio-ekonomike dhe financiare në të ardhmen, duke përfshirë edhe ndërlikime morale e etike dhe të demokracisë.

Në këtë situatë tejet komplekse, qeveritë vendore, duke qenë se ndodhen shumë pranë qytetarëve, mund dhe duhet të luajnë rol të rëndësishëm në menaxhimin e emergjencave, si dhe të qeverisin në mënyrë të tillë që të garantojnë rimëkëmbje dhe përgatitje për të ardhmen. Megjithatë, siç vihet re edhe nga raporte të tjera, reagimi i qeverive vendore, në nivel ndërkombëtar, ka qenë asimetrik nga pikëpamja territoriale. Kjo vjen për shkak të tipareve të ndryshme të sistemeve të qeverisjes në vende të ndryshme, veçorive territoriale dhe gjeografike, formës dhe nivelit të urbanizimit të qyteteve, nivelit të përgjithshëm të zhvillimit, si dhe niveleve të investimeve për mundësimin e aftësisë ripërtëritëse në nivel vendor.

Në Shqipëri, emergjenca e COVID-19 është menaxhuar nga qeveria qendrore, ku përfshirja e qeverive vendore ka qenë e ulët dhe e kufizuar. Ndonëse ligjërisht bashkitë luajnë rol domethënës në përballimin e fatkeqësive në të gjitha fazat (gatishmëri/përgatitje, reagim/përgjigje ndaj emergjencës, rimëkëmbje dhe planifikim për të ardhmen), ato janë të dobëta teknikisht dhe financiarisht për ta realizuar këtë rol. Situata është edhe më pak shpresëdhënëse në rastin e fatkeqësive biologjike, veçanërisht të pandemive, ku efekti dhe implikimet e fatkeqësisë nuk kufizohen në rang territori (janë ndërterritoriale) dhe përgjigja duhet të jetë e mirëkoordinuar në të gjitha nivelet e qeverisjes (vertikalisht) dhe midis të gjithë aktorëve (horizontalisht).

Andaj, fokusi i këtij dokumenti është pikërisht të hedhë dritë mbi mënyrën se si qeveritë vendore në Shqipëri reaguan gjatë emergjencës së COVID-19. Qëllimi është të vështrohen imtësisht rolet dhe sfidat e hasura prej tyre, e për rrjedhojë, të krijohet njohuria e nevojshme për përballimin e fatkeqësive dhe rimëkëmbjen në të ardhmen e afërt, si dhe të propozohen disa hapa bazë për mundësimin e aftësisë ripërtëritëse në nivel vendor. Dokumenti është përgatitur bazuar në gjetjet e një anketimi të përgjithshëm që Co-PLAN dhe Shoqata për Autonominë Vendore ka realizuar në muajin prill 2020 në të 61 bashkitë e Shqipërisë.

1.Shënim i autorëve: Në përputhje me ligjin për mbrojtjen civile, termi "reagim" në këtë dokument përdoret në mënyrë të ndërkëmbyeshme me termin *"përgjigje"*.

2. Referuar informacioneve të Organizatë Botërore të Shëndetësisë deri në 17 qershor 2020: https://www.who.int/docs/default-source/coronaviruse/situation-reports/20200617-covid-19-sitrep-149.pdf?sfvrsn=3b3137b0_8

## Sfondi

Në fillim të vitit 2020, Shqipëria u godit nga pandemia e COVID-19, e cila e pati zyrtarisht zanafillën në Kinë në dhjetor të 2019-s dhe u përhap gradualisht në mbarë botën që prej muajit janar 2020 e deri më sot. Kjo pandemi u shkaktua nga një lloj koronavirusi, sjellja dhe efektet e të cilit në organizimin e njeriut mbeten ende mjaft të panjohura për komunitetin shkencor. Deri më sot, janë shënuar mbi 8 milion raste të konfirmuara dhe mbi 440,000 vdekje në mbarë botën, me numra gjithnjë në rritje dhe me një ritëm (të valës së parë) që ndryshon nga dita në ditë.[3] Teksa shkencëtarët po mundohen të gjejnë përgjigje, të përditësojnë njohuritë e tyre dhe të japin këshilla ditë pas dite, qeveritë kombëtare dhe vendore kanë nisur maratonën e masave reaguese për siguri, përshtatje dhe pajtim me të panjohurën.

Rasti i parë me COVID-19 në Shqipëri u raportua zyrtarisht në 9 mars 2020.[4] Që prej asaj kohe, numri në total i rasteve të konfirmuara është rritur sipas një kurbe që ka pësuar luhatje ditore, duke shënuar 1788 të infektuar e 39 humbje jete[5] deri më 18 qershor 2020. Qeveria Shqiptare reagoi ndaj kësaj situate duke ndërmarrë një sërë masash shtrënguese, të cilat e çuan vendin në karantinë totale për rreth dy muaj, dhe më pas, në muajin maj, filloi të vinte në zbatim strategjinë e hapjes graduale. Gjatë periudhës 15 mars-30 prill, treguesi i ashpërsisë së masave për Shqipërinë[6] ishte 84.26 nga 100, i cili në fund të prillit[7] tejkaloi shifrën 89. Mbetet ende për t'u bërë një vlerësim për ndikimin e ashpërsisë dhe kohëzgjatjes së këtyre masave mbi shkallën e përhapjes së sëmundjes. Nga ana tjetër, efektet socio-ekonomike të karantinës po bëhen dita-ditës më të dukshme dhe pritet që të jenë të rënda. Burime të ndryshme shprehen se pandemia e COVID-19 do ta zhysë ekonominë shqiptare në recesion, çka do të sjellë rënie të PBB-së (-5% në skenarin më të mirë dhe -6.9% në skenarin më të keq nga rritja prej 2.2% në vitin 2019), rritje të shkallës së papunësisë dhe humbje të vendeve të punës puna, ku sektorët më të prekur janë turizmi dhe transporti (OECD, 2020; Banka Botërore, 2020; FMN, 2020; Nientied & Shutina, 2020). Në këto rrethana, qeveritë kombëtare dhe vendore duhet të fokusohen te zbatimi i strategjisë gjithëpërfshirëse të rimëkëmbjes, që trajton si aspektet shëndetësore, ashtu edhe ato socio-ekonomike.

Sipas Muggah (2020, f.16, përkthim dhe theksim i autorit) "Në kohë krize, populli… i kthen sytë nga qeveria për mbrojtje dhe ndihmë…Emergjencat zbulojnë se sa e efektshme është

3. Këto të dhëna paraqesin situatën e 17 qershorit 2020, të marra në faqen e internetit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë më 18 qershor 2020. Për informacione të mëtejshme, ju lutemi vizitoni linkun e mëposhtëm: https://www.who.int/docs/default-source/coronaviruse/situation-reports/20200617-covid-19-sitrep-149.pdf?sfvrsn=3b3137b0_8.

4. Për informacion të detajuar shiko: https://covid19.who.int/region/euro/country/al and https://new.shendetesia.gov.al/9-mars-2020-informacion-i-perditesuar-per-koronavirusin-covid_19/.

5. Këto të dhëna paraqesin situatën e datës 18 qershor 2020, sipas raportimit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale https://new.shendetesia.gov.al/covid-19-ministria-e-shendetesise-66-raste-te-reja-dhe-1-humbje-jete-ne-24-oret-e-fundit/.

6. Për informacione të mëtejshme dhe për të përllogaritur treguesin për periudha të ndryshme kohore, vizitoni: https://covidtracker.bsg.ox.ac.uk/stringency-scatter

7. Gjurmuesi i Oxford-it i Reagimit të Qeverive ndaj COVID-19 (OxCGRT) mbledh informacion në mënyrë sistematike për politikat e ndryshme reaguese që kanë ndërmarrë qeveritë, për të përllogaritur treguesin e ashpërsisë. Treguesi regjistron numrin dhe ashpërsinë e politikave qeveritare nga 0 në 100, ku 100 përfaqëson nivelin më të lartë të ashpërsisë së masave. Të dhënat janë mbledhur nga informacione të bëra publike nga ekipi ndërdisiplinor i akademikëve dhe studentëve të Universitetit të Oxford-it, nën drejtimin e Shkollës Blavatnik për Qeverisjen (Blavatnik School of Government). Për informacione të mëtejshme rreth treguesit dhe metodologjisë, ju lutemi vizitoni: https://covidtracker.bsg.ox.ac.uk and https://www.bsg.ox.ac.uk/research/research-projects/coronavirus-government-response-tracker.

*kontrata sociale* që kanë nënshkruar palët. Dhe në *kohë krize*, aftësitë kanë shumë rëndësi".

Deri më tani, në rang ndërkombëtar, reagimet më të shpejta ndaj COVID-19 erdhën pikërisht nga qeveritë vendore (Muggah, 2020), edhe pse jo në gjitha vendet ndodhi kështu. Në fakt, siç shprehet edhe Allain-Dupre (2020) në raportin e OECD-së, ndonëse qeveritë vendore ishin në vijën e parë të reagimit ndaj COVID-19, si roli i tyre, ashtu edhe efektet e pandemisë ishin asimetrike. Jo vetëm që reagimi dhe përgjigja ndryshonte nga vendi në vend dhe nga rajoni në rajon, por edhe niveli i centralizimit ose decentralizimit të veprimeve ishte i ndryshëm.

Në Shqipëri, ishte qeveria kombëtare ajo që e drejtoi dhe vazhdon ta drejtojë të gjithë procesin e menaxhimit të krizës. Qeveria shpalli gjendjen e fatkeqësisë natyrore më 24 mars 2020 për një periudhë kohore prej 30 ditësh me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 243, për ta zgjatur më pas për dy muaj të tjerë deri më 23 qershor 2020 me vendim kuvendi, siç parashikohet në Kushtetutë. Brenda këtij kuadri, qeveria ndërmori një sërë masash kufizuese si mbyllja e kufijve, ora policore, izolimi dhe karantina, mbyllja e shkollave dhe e aktiviteteve të tjera publike, ndalimi i udhëtimeve dhe i lëvizjes me mjete motorike, ndalimi i frekuentimit të hapësirave publike dhe parqeve, etj.

Mbeten ende për t'u ndërmarrë vlerësime të strukturuara rreth qasjes së përdorur nga qeveria për të reaguar ndaj pandemisë. Megjithatë, kjo qasje ngjet më tepër me një qasje elitiste (Marisam, 2008), ku pushteti qendror merr përsipër të gjithë vendimmarrjen lidhur me politikat e veprimet, sipas arsyetimeve të një grushti ekspertësh (përgjithësisht të shëndetësisë). Një qasjeje e tillë kufizon liritë dhe nuk lë vend për vendimmarrje demokratike me argumentin se në këtë mënyrë në rast fatkeqësish, evitohet marzhi i lartë i gabimit në vlerësimin e riskut (po aty). Mirëpo, kjo qasje nuk arrin t'i vërë në përdorim njohuritë lokale rreth aspekteve të rëndësishme të vlerësimit të riskut, si dhe nuk merr parasysh vlerat dhe normat shoqërore, që normalisht duhen adresuar për të shmangur ndërlikime të mundshme etike.

Siç shprehen French dhe Raymond (2009), gjatë një pandemie, moria e ndërlikimeve ligjore dhe etike është e pafundme për shkak të prekjes së lirive qytetare dhe të të drejtave të njeriut, cenimit të dinjitetit njerëzor, vaksinimit të detyruar, humbjes së privatësisë individuale, etj. Ndër të tjera, duhet marrë edhe vendimi se cili nivel qeverie është më i përshtatshëm për të siguruar zbatimin e detyruar të këtyre masave, gjë që varet nga qasja e përgjithshme e menaxhimit që një qeveri ndjek në kohë krize. Për gjendjen e fatkeqësisë natyrore, Kushtetuta e Shqipërisë dhe Vendimi Nr. 243 parashikojnë kufizime[8] të lirive themelore qytetare për një periudhë kohore prej 3 muajsh, të cilat përfshijnë: paprekshmërinë e banesës; lirinë e lëvizjes; shpronësimin e drejtë me çmimin e tregut; lirinë për të zgjedhur profesionin, për të punuar dhe për të përfituar nga mbrojtja sociale; dhe të drejtën për të bërë grevë për praktika pune të padrejta. Për më tepër, izolimi dhe karantina totale në të cilën popullata u vendos për dy muaj rresht solli shumë vështirësi në jetesën e grupeve të ndryshme të qytetarëve, veçanërisht të grupeve të cenueshme. Për shembull, qytetarëve që jetonin në periferi të Tiranës dhe Durrësit iu kufizua aksesi në njësi ushqimore dhe farmaci për shkak të kufizimit të qarkullimit me automjete dhe ndalimit të transportit publik. Të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara iu cenua ndjeshëm rutina e tyre ditore, e për pasojë edhe mënyra e jetesës, duke qenë se ishin grupe shumë të rrezikuara. Izolimi pati efekte psikologjike e shëndetësore edhe te fëmijët, të cilët u detyruan të qëndronin brenda banesave, pa pasur mundësi të frekuentonin hapësirat publike.

8. Për më tepër informacion rreth këtyre kufizimeve, shihni nenet 174, 37, 38, 41 pika 4, 49 dhe 51 të Kushtetutës së Shqipërisë (ligji nr. 8417, datë 21.10.1998, ndryshuar).

Ndoshta, do të kishte qenë shumë herë më e përshtatshme ndjekja e një qasjeje komunitare (komunitarianizmi). Kjo e fundit ka veçorinë e shmangies së efekteve negative si të mënyrës tejet të centralizuar, ashtu edhe të mënyrës tejet të decentralizuar të të vepruarit. Komunitarianizmi ruan ekuilibrin midis sigurisë së qytetarëve dhe lirive qytetare. Në këtë kontekst, qeveritë vendore në Shqipëri mund të kishin luajtur rol të rëndësishëm në menaxhimin e krizës. Si rregull, duke qenë më pranë komuniteteve dhe territoreve, qeveritë vendore luajnë rol të qenësishëm në përballimin e fatkeqësive në të gjitha fazat, duke filluar që nga planifikimi dhe përgatitja[9], e deri te reagimi ndaj krizës, rimëkëmbja dhe zbutja (Toto, 2020; French & Raymond 2009; French, 2011). Bashkitë janë dera e parë ku qytetarët trokasin për ndihmë dhe mbështetje në rast të emergjencave nga fatkeqësitë, jo vetëm për shkak të afërsisë, por edhe për shkak të parimit të subsidiaritetit dhe kuadrit ligjor për qeverisjen vendore (shihni French, 2011). Në rastin e rreziqeve natyrore territoriale, kjo gjë është edhe më e dukshme, por në rastin e fatkeqësive biologjike, situata paraqitet disi më e paqartë. Siç tregon edhe vetë përkufizim i termit, menaxhimi i pandemisë është një shqetësim ndërterritorial (nga vendoro-kombëtar deri në rajonalo-global). Prandaj, interesat dhe mobilizimi i palëve të interesit, si dhe ndërlidhja në nivel territorial janë sfida komplekse të hasura rëndom, të cilat i japin formë reagimit politik dhe ndërlikimeve të mundshme, si dhe përfshijnë të gjitha (Sivaramakrishnan, 2011) nivelet e qeverisë. Megjithatë, duke qenë se i gjithë komunikimi rreth masave në Shqipëri u krye nga Ministria e Shëndetësisë dhe Kryeministri, mbetet ende e paqartë se deri në ç'masë kanë kontribuar qeveritë vendore në menaxhimin e situatës.

Në përgjithësi, qeveritë vendore mund të garantojnë menaxhim efikas, të drejtë dhe demokratik të pandemisë përmes të paktën dy mekanizmave themelore dhe plotësuese të njëra-tjetrës: i) galvanizimi i bashkëpunimit, koordinimit dhe i ndarjes së njohurive mes palëve të interesit, si dhe në nivel territori; ii) përmirësimi i qytetit dhe hapësirave urbane për të reaguar më mirë ndaj emergjencave të epidemive/pandemive, rimëkëmbjes dhe zbutjes. Qytetet janë vektor thelbësor i përhapjes së sëmundjes infektive, por në të njëjtën kohë qytetet mbartin në vetvete edhe zgjidhjen e krizës (Muggah, 2020). Sëmundjet infektive janë kërcënim i pashmangshëm veçanërisht për zonat urbane për shkak të numrit të madh të popullsisë, globalizimit të lëvizjes, ndotjes së ajrit, higjienës së dobët urbane në zona të populluara, dekarbonizimit të pamjaftueshëm të sektorit të transportit dhe mungesës së infrastrukturës së gjelbër e hapësirave të hapura publike. Në këto rrethana, strategjitë tradicionale të menaxhimit të epidemive dhe pandemive nuk mund t'i plotësojnë nevojat e qyteteve me popullsi të dendur (Bell et al., 2009). Për pasojë, kjo sjell nevojën për metoda novatore, që nxisin komunikimin e hapur e transparent, si dhe angazhimin e qytetarëve në përgatitje dhe reagim përmes qeverisjes bashkëpunuese shumënivelëshe, të njohur ndryshe edhe si qasja "e gjithë shoqëria" në reagimin ndaj pandemisë (Schwartz & Yen, 2017; French, 2011; Bell et al., 2009) (shihni edhe Allain-Dupre, 2020 dhe Rajadhyaksha, 2020). Kjo lloj qasjeje mundëson ndarjen e njohurive me palët e interesit (French, 2011), si dhe rrit besimin e komunitetit te qeveria (Schwartz & Yen, 2017).

Ndërkohë, megjithëse konsiderohen si nxitësit e zhvillimit, qytetet janë edhe vatra e pabarazive socio-ekonomike dhe hapësinore, e jo rrallëherë edhe e varfërisë, duke u ekspozuar kështu më shumë dhe duke qenë më tepër të cenueshme nga sëmundjet infektive (De La Barra, 2000). Kjo e fundit ka qenë edhe një nga arsyet më të forta ku janë mbështetur vendimet më të rëndësishme mbi zhvillimet e transformimet urbane (po aty., f.8; Indorewala & Waghs, 2020). Ky lloj cikli mbështet edhe gjetjen se organizimi urban (madhësia, forma, ambientet

9. Shënim i autorëve: Në përputhje me ligjin për mbrojtjen civile, termi "përgatitje" në këtë dokument përdoret në mënyrë të ndërkëmbyeshme me termin "gatishmëri".

e hapura publike, rrjeti rrugor, raporti hapësirë-ndërtim, grupimi, peizazhi, depërtimi i ekosistemeve natyrore në zemrën urbane, përdorimi i përzier i tokës, densiteti, etj.) sjell pasoja domethënëse dhe luan rol të rëndësishëm në mundësimin e aftësisë ripërtëritëse në nivel vendor (Sharifi, 2019; Jabareen, 2013; Waller & Chakrabarti, 2020; Hooper, 2020), përfshi edhe aftësinë për të menaxhuar emergjencat nga pandemitë. Krahas organizimit urban, cilësia dhe aksesi në shërbime publike dhe infrastrukturë kritike janë ndër elementet kyçe që zvogëlojnë pabarazitë territoriale dhe zbusin efektet negative të faktorëve periferikë (shihni Tagai et al., 2017). Qeveritë vendore janë më të përshtatshmet nga të gjithë aktorët qeveritarë për të ofruar me efikasitet shërbime cilësore dhe për të ndikuar organizimin urban, në mënyrë që t'i përgjigjet nevojave të komunitetit dhe mundësuar jetesën në qytete dhe aftësinë e tyre ripërtëritëse (Toto, 2020; Alam, 2008). Prandaj, supozimi se qeveritë vendore luajnë rol jetik në menaxhimin e emergjencave nga pandemitë, që nga zbutja e deri te rimëkëmbja, nuk është thjesht përfundim empirik, por qëndron në thelb të kuadrit konceptual të vetë ekzistencës së QV-ve.

Ky dokument politikash niset pikërisht nga pohimi i fundit dhe analizon reagimin e qeverive vendore në Shqipëri gjatë periudhës janar-prill 2020, duke u fokusuar kështu në periudhën përpara shpërthimit dhe në periudhën e kulmit të emergjencës. Analiza mbështetet në gjetjet e një anketimi (ose censusi) të përgjithshëm, të kryer për këto qëllime në të 61 bashkitë nga Shoqata për Autonominë Vendore në bashkëpunim me Co-PLAN, Institutin për Zhvillimin e Habitatit. Metodologjia e anketimit të përgjithshëm dhe struktura e dokumentit paraqiten në kreun në vijim.

Qëllimi parësor i analizës dhe i këtij dokumenti është të ndajë informacion mbi reagimin e qeverive vendore ndaj emergjencës së COVID-19. Për më tepër, dokumenti përshkruan edhe sfidat e hasura nga bashkitë dhe nevojat e tyre në të ardhmen e afërt, që lidhen kryesisht me proceset e rimëkëmbjes. Zakonisht, pandemitë vijnë me valë dhe zgjasin mesatarisht 18 muaj (French & Raymond, 2009). Ndonëse COVID-19 nuk mund të parashikohet ende në këto terma dhe në lidhje me efektin shëndetsor, shkencëtarët dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë paralajmërojnë një valë të dytë të mundshme dhe ndoshta edhe një të tretë nga fundi i 2020-s dhe fillimi i 2021-it. Prandaj, ka shumë rëndësi që qeveritë vendore të përgatiten për t'u përballur me të ardhmen e panjohur, dhe me shumë gjasë, tejet të vështirë të pandemisë. Krahas kësaj, njohuritë dhe mësimet e nxjerra nga situata aktuale do të ndihmonin shumë në përgatitjen dhe mundësimin e aftësisë ripërtëritëse në nivel vendor për skenarin afatgjatë të përhapjes së pashmangshme dhe pranisë së sëmundjeve infektive.

## 1. Metodologjia e anketimit dhe struktura e dokumentit të politikës

Reforma administrativo-territoriale[10] e 2014-2015s e riorganizoi nivelin e parë të vetëqeverisjes vendore në Shqipëri në 61 bashki nga 373 që ishin përpara saj. Reforma nuk i bëri asnjë ndryshim nivelit të dytë të qeverisjes vendore, e cila përbëhej nga 12 qarqe.[11] Duke qenë më pranë qytetarëve, bashkitë mund t'i trajtojnë më mirë nevojat e komunitetit se sa nivelet e tjera të qeverisjes për shkak të afërsisë dhe avantazheve lidhur me informacionin. Kuadri ligjor dhe parimi i subsidiaritetit i vendos bashkitë në vijën e parë të veprimeve, mes të tjerash, të ndërmarra për zvogëlimin e risqeve të fatkeqësive në nivel vendor. Në këto kushte, u hamendësua se bashkitë në Shqipëri do të luanin rol parësor në përballimin e emergjencës së COVID-19 në territoret e tyre, pavarësisht sfidave që lindën kryesisht nga natyra e pazakontë e kësaj ngjarjeje fatkeqësie.

Për të kuptuar reagimin në nivel bashkie të Shqipërisë ndaj emergjencës së COVID-19, Co-PLAN dhe Shoqata për Autonominë Vendore (SHAV) ndërmorën një anketim (census) në 61 bashkitë (popullata e synuar) gjatë muajit prill 2020. Shtysa për të kryer një anketim ose census të përgjithshëm që t'i përfshinte të 61 bashkitë, dhe në këtë mënyrë edhe aktorë të tjerë të qeverisjes në nivel vendor, ishte pikërisht diversiteti që bashkitë paraqesin për sa i përket madhësisë dhe vendndodhjes gjeografike, pabarazive territoriale, kapaciteteve institucionale dhe financiare, si dhe gatishmërisë për t'u përballur me risqet e fatkeqësisë.

Reagimi i bashkive në Shqipëri ndaj emergjencës së COVID-19 u analizua përmes një pyetësori të strukturuar (shihni shtojcën 1), i cili u dërgua me email dhe u hartua në gjuhën shqipe. Pyetësori përfshinte 31 pyetje në total në formën e pyetjeve me alternativa, pyetjeve renditëse, si dhe pyetjeve të hapura e të mbyllura. Pyetjet dhe përgjigjet e pritshme janë të vlefshme për periudhën janar-prill 2020 dhe synojnë marrjen e informacioneve lidhur me:

- situatën e përgjithshme të përhapjes së COVID-19 në nivel vendor dhe shkallën e fleksibilitetit të strukturave bashkiake për t'u përshtatur me një mjedis ndryshe pune (pyetje 1-7);
- komunikimin dhe bashkëpunimin e qeverive vendore me qytetarët dhe palët e tjera të interesit për të përballuar emergjencën, duke siguruar ndihmë të menjëhershme veçanërisht për ata në situata të pafavorizuara (pyetje 7, 12, 13, 17-21);
- rolin dhe masat e ndërmarra nga bashkitë për të mbështetur banorët vendas (pyetjet 8-11 dhe 14 – 16);
- problemet dhe sfidat e hasura lidhur me ofrimin e shërbimeve publike vendore, plotësimin e nevojave të grupeve të cenueshme, financat vendore dhe efektet e mundshme socio-ekonomike (pyetje 22 – 30);
- nevojat bashkiake që duhen plotësuar për të trajtuar ndikimet shëndetësore dhe socio-ekonomike gjatë pjesës së dytë të 2020-s dhe vitit 2021 (pyetje 31).

Anketimi (censusi) i përgjithshëm i 61 bashkive u realizua kryesisht gjatë gjysmës së dytë të muajit prill 2020, kur masat e izolimit dhe të karantinës kundër COVID-19 ishin në një stad të përparuar. Pyetësori iu dërgua 61 kryebashkiakëve nga SHAV-ja me email në datën 7 prill 2020, ku 30 prilli 2020 ishte afati për dorëzimin e përgjigjes. Bashkitë pjesëmarrëse i ofruan informacionet përkatëse deri në datën kufi të 30 prillit 2020 dhe shkalla e kthimi të përgjigjes

10. Ligji Nr. 115/2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë"

11. Njohur si rajonet e hartës NUTS 3 në Shqipëri. Çdo qark përbëhet nga 3-7 bashki në rang territori

ishte 85.2% (ose 52 nga 61 bashki). Përpunimi i të dhënave të pyetësorit përfshin këto hapa:

- Kodimin e pyetësorit nga cilësor në sasior, si hap i nevojshëm për përpunimin e informacionit në programe kompjuterike (software) statistikore;
- Hedhjen e të dhënave në një format të caktuar nga stafi i trajnuar, bazuar në informacionin e koduar;
- Pastrimin e bazës së të dhënave nga gabimet e mundshme drejtshkrimore;
- Përpunimin e të dhënave, i cili u krye pjesërisht në Excel dhe pjesërisht në programin SPSS V.20 (Paketa Statistikore për Shkencat Sociale). Metoda e përdorur e agregimit, bazuar në llojet e pyetjeve, ishte sipas frekuencës [përqindja e të anketuarve që zgjidhnin një alternativë të caktuar kundrejt përgjigjeve në total] dhe mesatareve të thjeshta. Në rast se nuk ishte ofruar informacion për ndonjë pyetje, rezultatet u përshkallëzuan për të pasqyruar vetëm përgjigjet e vlefshme dhe numrin e të anketuarve që iu përgjigjën çdo pyetjeje.
- Lidhjen reciproke (korrelacioni) midis pyetjeve "po-jo" si dhe verifikimin e lidhjes midis ndryshimeve dhe pabarazive territoriale nga njëra anë dhe gjetjeve të anketimit nga ana tjetër.

Informacioni i përftuar nga pyetësori paraqitet në tabela, grafikë si dhe në disa raste edhe në harta, të cilat gjenden në kreun e dytë të këtij dokumenti politikash. Ky kre paraqet analizën e detajuar të gjetjeve lidhur me reagimin e qeverive vendore gjatë periudhës janar-prill 2020. Kreu i parë - sfondi, i paraprin gjetjeve të anketimit, duke dhënë informacione për COVID-19 dhe menaxhimin e tij në nivel global dhe kombëtar. Ky kre paraqet edhe kuadrin teorik dhe të politikëbërjes, aspekte të të cilit merren sërisht kryesisht në kreun tre.
Kreu tre vijon më tej me analizën e gjetjeve të anketimit duke:

- diskutuar decentralizimin dhe qeverisjen shumënivelëshe të COVID-19 nga pikëpamja e qeverisë vendore;
- hetuar financat vendore dhe pasojat e mundshme në të ardhmen;
- analizuar lidhjen midis pabarazive territoriale, planifikimit dhe shpërndarjes së rreziqeve natyrore përgjatë territorit.

Dokumenti përmbyllet me një sintezë për drejtimin në nivel vendor, decentralizimin dhe qeverisjen shumënivelëshe, planifikimin, aftësinë ripërtëritëse dhe financat vendore, si dhe me rekomandime për forcimin e rolit të qeverive vendore gjatë fazave afatshkurtra deri afatgjata të menaxhimit të rrezikut të pandemisë.

## 2. Reagimi i Qeverive Vendore në Shqipëri gjatë emergjencës së COVID-19 - gjetjet e anketimit të përgjithshëm

Ky kre paraqet përmbledhjen e rezultateve të anketimit të përgjithshëm të 61 bashkive në Shqipëri, që synonte të hidhte dritë mbi reagimin e tyre ndaj COVID-19 dhe mbi sfidat për t'u trajtuar në terma afatmesëm deri afatgjatë. Bashkitë pjesëmarrëse (siç tregohet në figurën 1) i dhanë informacionet përkatëse deri në datën kufi të 30 prillit 2020, dhe shkalla e kthimit të përgjigjes ishte 85.2% (ose 52 nga 61 bashki). Figura 1 tregon bashkitë që kanë pasur raste të infektuara me koronavirus deri në datën kufi të 3 qershorit 2020, si dhe densitetin e rasteve të infektuara për 10,000 banorë, bazuar në të dhënat e raportuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Instituti i Shëndetit Publik.

***Figura 1.*** Bashkitë që morën pjesë në anketim (majtas); raste/10,000 banorë, 3 qershor 2020 (djathtas)




*Burimi: Co-PLAN & Shoqata për Autonominë Vendore, 2020*

## *2.1 Reagimi në nivel bashkie ndaj emergjencës*

COVID-19 e goditi Shqipërinë pak pas fatkeqësisë së tërmetit të 26 nëntorit 2020, duke e gjetur qeverisjen vendore dhe atë kombëtare në përpjekje e sipër të procesit të rimëkëmbjes pas fatkeqësisë natyrore. Në nivel vendor, përgatitja kundër pandemisë ishte e ulët, për të mos thënë që mungonte, për shkak të mungesës së njohurive rreth sëmundjes, por edhe për shkak se bashkitë kanë struktura të dobëta të mbrojtjes civile dhe nuk kanë ende strategji për riskun e fatkeqësive (për më tepër shihni Toto, 2020). Nga ana tjetër, pjesa më e madhe e fazës së përgatitjes po zhvillohej në nivel kombëtar, menjëherë goditjes së Kinës nga virusi dhe paralajmërimit të OBSH-së që vendet duhet të fillonin të merrnin masa mbrojtëse. Më 4 janar 2020, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) nxori urdhrin e Ministrit për përgatitjen, mbrojtjen dhe parandalimin e koronavirusit të ri drejtuar institucioneve shëndetësore në Shqipëri. MSHMS-ja filloi të ndante informacione publike ditore me qytetarët për numrin zyrtar të rasteve të infektuara në nivel kombëtar që në 31 janar 2020.[12]

Krahas masave shtrënguese dhe kufizuese të ndërmarra në nivel qendror, bashkitë u përballën me nevojën e pashmangshme për të përshtatur proceset e tyre të ofrimit të shërbimeve vendore dhe për të reaguar në kohë ndaj emergjencës shëndetësore brenda fushës së kompetencave të parashikuara me ligj. Megjithatë, përhapja e infeksionit nuk ishte e barabartë për të gjitha territoret, gjë që vërehet edhe sot e kësaj dite. Prandaj, shpërndarja e pabarabartë e rasteve të infektuara, si dhe madhësia e pabarabartë e sipërfaqes dhe e popullsisë së bashkive ndikoi edhe tek mënyra se si masat u zbatuan përgjatë kohës në të gjithë vendin.

Në datën e fundit të anketimit të përgjithshëm, 38.5% ose 20 bashki raportuan së në territoret e tyre përkatëse kishte persona të infektuar, ku disa bashki ishin goditur më shumë se të tjerat (grafiku 1). Numri më i lartë i rasteve pozitive u shënua në bashkitë e Tiranës (54.4%), Shkodrës (20.4%) dhe Fierit (4.6%), si në qytete, ashtu, edhe në njësitë administrative. Sipas censusit të 2011-s, këto bashki përbëjnë rreth 31% të popullatës së përgjithshme dhe karakterizohen nga shkëmbime intensive tregtare dhe sociale, çka rritën edhe probabilitetin për infektim. Sipas shifrave zyrtare, thuajse i njëjti trend vërehet edhe në fund të majit 2020, ku qarku i Tiranës, Durrësit dhe Shkodrës përbënin 80% të rasteve në total. Ky lloj trendi konfirmon edhe gjetjet ndërkombëtare të OECD-së (Allain-Dupre, 2020) mbi ndikimin asimetrik të emergjencës në nivel vendor.

12. Për më tepër informacione rreth komunikimeve publike zyrtar në rang kombëtar, ju lutemi referojuni Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale: https://shendetesia.gov.al/koronavirusi-i-ri-dhe-masat-ndaj-tij/.

***Grafiku 1.*** Shpërndarja e rasteve pozitive sipas bashkive




*Burimi: Co-PLAN & Shoqata për Autonominë Vendore, 2020*

Siç raportojnë edhe vetë bashkitë, mbi 67% e rasteve pozitive janë trajtuar në shtëpi, ndërsa 30% janë transferuar në Pavionin e Sëmundjeve Infektive të Spitalit Universitar "Nënë Tereza" në Tiranë. Spitalet rajonale pritën (gjatë periudhës së raportimit) vetëm 2.7% të rasteve pozitive, sipas raportimit të vetë bashkive.

Qeveritë vendore janë përgjegjëse për ofrimin e një sërë shërbimesh për komunitetin. Prandaj, ngjarjet e fatkeqësive ndikojnë drejtpërdrejt te aftësia e tyre për t'iu përgjigjur qytetarëve, jo vetëm lidhur me menaxhimin e emergjencës së fatkeqësisë, por kryesisht lidhur me ofrimin e shërbimeve të tjera. Në këtë kontekst, bashkitë në Shqipëri hasën sfida në tre drejtime:

1. *Ofrimin e shërbimeve thelbësore publike brenda kufizimeve të vendosura për shkak të emergjencës shëndetësore.* Reagimi i bashkive në këtë drejtim ndryshon ndjeshëm, por gjithsesi, vërehen disa pika të përbashkëta:
   - për shumicën e bashkive, dy sektorë kryesorë, ai i arsimit parashkollor dhe ai i arsimit parauniversitar, si dhe planifikimi urban dhe menaxhimi i territorit filluan të funksiononin në internet (online). Ka edhe disa bashki të pakta në numër të cilat raportojnë se pothuajse çdo sektor filloi të funksiononte pjesërisht online.
   - Gjendja civile (aplikimi për dokumente identifikimi) dhe zyrat me një ndalesë ishin sektorët që u pezulluan në shumicën e bashkive. Ka pasur edhe raste të pezullimit të aktiviteteve të tjera, ndonëse më të pakta. Këto të fundit përfshijnë integrimin në BE; komunikimin dhe marrëdhëniet me publikun; financat dhe buxhetin; tarifat dhe taksat vendore; menaxhimin e aktiveve; kulturën, turizmin dhe sportin; punën me dokumente fizike në gjykata dhe arkiva; projektet dhe koordinimin me donatorët; shërbimet sociale dhe strehimin; transportin publik, etj.
   - Mbrojtja sociale, shërbimet publike (pavarësisht disa vështirësive në shërbime specifike), financat dhe buxheti, dhe mbrojtja sociale vijuan rregullisht punën, ku stafi paraqitej fizikisht në bashki/terren, në përputhje me rregullat dhe rregulloret. Disa bashki të pakta në numër zgjodhën të pakësonin numrin e punonjësve të pranishëm në zyrë, që ndonjëherë reduktohej deri në një person për departament, me rotacion.
2. *Ruajtjen e ekuilibrit të pranisë së burimeve njerëzore në zyrë përmes organizimit të punës në internet, nëpërmjet përdorimit të teknologjisë.* Reagimet e bashkive

konvergojnë në praktika të ngjashme pune gjatë COVID-19, të cilat u sugjeruan të përdoreshin kryesisht në nivel kombëtar. Bashkitë e anketuara zbulojnë se puna u organizua në turne. Për më tepër, ata i kishin lehtësuar kushtet e punës (reduktim i orëve të punës ose punë nga shtëpia online) për prindërit me fëmijë nën 14 vjeç dhe për ata që ishin të ekspozuar ndaj risqeve. Sektorët dhe punonjësit, puna e të cilëve ka të bëjë me dokumente dhe raporte, apo shërbime që nuk kërkojnë domosdoshmërish prani fizike, punuan online. Mesatarisht, 67% e punonjësve bashkiakë kanë qenë të pranishëm fizikisht në zyra, sipas raportimeve të bashkive. Prania fizike minimale e raportuar ishte 15%, ndërsa ajo maksimale (100%) u raportua nga bashkia e Selenicës. Vetëm tetë nga 52 bashki raportuan prani fizike në zyra të stafit nën nivelin 50%, ndërsa 26 bashki raportuan se prania fizike në zyrat e tyre ishte mesatarisht 67%.

3. *Sigurimin e vijimësisë së vendimmarrjes së institucioneve legjislative vendore.* Bashkitë e anektuara raportuan se u realizuan online, përmes mbledhjeve në internet, jo vetëm menaxhimi i shërbimeve, por edhe proceset e vendimmarrjes vendore të Këshillit Bashkiak.

## *2.2 Komunikimi dhe bashkëpunimi me qytetarët dhe palët e tjera të interesit*

Komunikimi dhe bashkëpunimi me qytetarët dhe palët e tjera të interesit janë kyç për mirëqeverisjen shumënivelëshe, si dhe janë shumë të rëndësishme për të ofruar reagim efikas ndaj emergjencës dhe minimizim të efekteve negative të ngjarjeve të fatkeqësisë. Bashkive iu kërkua të jepnin informacion lidhur me komunikimin me palët institucionale të interesit (Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC) dhe institucione të tjera) dhe temën e këtij komunikimi. Në përgjithësi, për të tre alternativat, shumë pak bashki raportuan të kishin pasur komunikime gjatë muajve janar dhe shkurt. Për disa aspekte si taksat vendore, shpërndarjen e pakove ushqimore, ruajtjen e rendit dhe sigurisë, ofrimin e shërbimeve dhe grupet vullnetare nuk pati aspak komunikim gjatë dy muajve të parë. Megjithatë, sipas raportimeve të bashkive, komunikimi për të gjitha temat u rrit ndjeshëm gjatë dy muajve të ardhshëm: marsit dhe prillit. Ky trend lidhet me zbulimin e dy rasteve të para me COVID-19 në Shqipëri, të bëra publike nga MSHMS-ja më 9 mars 2020.

Komunikimet me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale duket se kanë qenë të pakta gjatë muajit janar, pasi vetëm 3 bashki raportojnë të kenë mbajtur komunikim, siç vërehet edhe në grafikun 2. E njëjta gjë vlen edhe për muajin shkurt, siç raportohet nga 10 bashki. Komunikimet me MSHMS-në pësuan rritje të menjëhershme në mars dhe një rënie të lehtë në prill (shihni grafikun 2, tabelën 1). Sipas raportimit të bashkive, të gjitha temat e renditura ishin objekt i komunikimit me MSHMS-në, në mënyrë të veçantë: ndarja e informacionit përpara dhe gjatë krizës, informacione mbi masat e ndërmarra nga qeveria qendrore, udhëzimet për bashkitë gjatë krizës dhe udhëzimet për mënyrën e procedimit me ndihmën sociale/rrjetet shoqërore. Komunikimet kanë qenë më të pakta rreth udhëzimeve lidhur me taksat vendore, bashkëpunimin për transportimin e personave të infektuar dhe bashkëpunimin për ruajtjen e rendit dhe sigurisë.

*Table 1.* Communication with other institutions

| **Numri i komunikimeve të të gjitha bashkive në muaj për palë interesi** | MSHMS | | AKMC | | Të tjera: Prefektura, AMVV, Inspektorati Shëndetësor, Policia | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Mars** | **Prill** | **Mars** | **Prill** | **Mars** | **Prill** |
| Numri i të anketuarve | 48 | 43 | 47 | 43 | 38 | 36 |
| Ndarja e informacionit përpara dhe gjatë krizës | 44 | 36 | 44 | 40 | 32 | 30 |
| Informacion rreth masave të qeverisë qendrore | 40 | 34 | 39 | 33 | 31 | 28 |
| Kërkesë për informacion rreth rasteve pozitive | 30 | 24 | 30 | 25 | 25 | 21 |
| Kërkesë për informacion rreth personave të cenueshëm | 30 | 25 | 41 | 27 | 29 | 26 |
| Udhëzime për bashkitë gjatë krizës | 40 | 36 | 39 | 34 | 28 | 26 |
| Udhëzime lidhur me taksat vendore | 8 | 6 | 6 | 4 | 7 | 6 |
| Udhëzime për menaxhimin e rrjeteve shoqërore | 37 | 32 | 20 | 18 | 14 | 13 |
| Udhëzime për shpërndarjen e pakove ushqimore | 28 | 24 | 37 | 34 | 18 | 16 |
| Bashkëpunim për ngritjen e grupeve vullnetare | 25 | 20 | 34 | 29 | 19 | 18 |
| Bashkëpunim për transportimin e personave të prekur | 12 | 11 | 10 | 8 | 11 | 11 |
| Bashkëpunim për ruajtjen e rendit dhe sigurisë | 13 | 11 | 25 | 22 | 28 | 26 |
| Udhëzime për ofrimin e shërbimeve | 32 | 30 | 27 | 25 | 17 | 16 |
| Të tjera | 7 | 7 | 4 | 3 | 2 | 2 |

*Burimi: Co-PLAN & Shoqata për Autonominë Vendore, 2020*

Komunikimi me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile ndjek trende të ngjashme me komunikimin e MSHMS-së: relativisht i dobët gjatë muajve janar dhe shkurt, me 5 dhe 10 bashki përkatësisht, mbi të gjitha temat e sugjeruara në grafikun 3. Pas shpalljes së gjendjes së emergjencës nga autoritetet, komunikimet vertikale me AKMC-në u rritën ndjeshëm, ku raportohet për një rënie të lehtë në prill. Gjatë muajve mars prill, ka pasur komunikime mjaft intensive lidhur me aspekte të tilla si: ndarja e informacionit përpara dhe gjatë krizës, informacion mbi masat e ndërmarra nga qeveria qendrore, udhëzime për bashkitë gjatë krizës, udhëzime për mënyrën e procedimit me shpërndarjen e pakove ushqimore dhe bashkëpunim për ngritjen e grupeve vullnetare. Komunikimet kanë qenë më të pakta rreth udhëzimeve lidhur me taksat vendore dhe bashkëpunimin për transportimin e personave të infektuar.

Komunikimet me aktorë të tjerë të tillë si Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV), Prefekti, Policia e Shtetit, Inspektorati Vendor Shëndetësor (IVSH) kanë ndjekur

trende të ngjashme me komunikimet me MSHMS-në dhe AKMC-në (grafiku 4 dhe tabela 1) Komunikimet kanë qenë të kufizuara në janar dhe shkurt, por janë intensifikuar gjatë dy muajve të ardhshëm. Sipas raportimeve të 38 bashkive, frekuenca e lartë e komunikimeve me këto institucione lidhej gjerësisht me: ndarjen e informacionit për situatën përpara dhe gjatë krizës, informacionin për masat e ndërmarra nga qeveria qendrore, kërkesë për informacion rreth numrit të të infektuarve, kërkesë për informacion rreth grupeve të cenueshme dhe bashkëpunim për ruajtjen e rendit dhe sigurisë. Komunikimet kanë qenë më të rralla lidhur me udhëzimet për taksat vendore, bashkëpunimin për transportin e personave të infektuar dhe menaxhimin e ndihmës sociale/rrjeteve shoqërore.

***Grafiku 2.*** Intensiteti i komunikimeve me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale *(numri i komunikimeve, tema e të cilave është zgjedhur nga bashkitë)*




*Burimi: Co-PLAN & Shoqata për Autonominë Vendore, 2020*

Krahas kategorive të institucioneve të përmendura më lart, bashkitë raportojnë se kanë bashkëpunuar edhe me institucione të tjera për menaxhimin e krizës së COVID-19. Në nivel vendor, të gjitha bashkitë kanë mbajtur komunikime dhe kanë bashkëpunuar vazhdimisht me drejtoritë vendore të policisë së shtetit, prefekturën dhe degët vendore të Shërbimit Postar Shqiptar. Në nivel kombëtar, të gjitha bashkitë kanë mbajtur komunikime me Ministrinë e Brendshme dhe Kryeministrinë (KM). Bashkitë kanë komunikuar edhe me institucione të tjera, ndonëse në mënyrë më sporadike, të cilat përfshijnë: Komisionin Qendror për Ofrimin e Asistencës, Agjencinë e Prokurimit Publik, Drejtorinë e Shërbimeve Spitalore dhe Shëndetit Publik, Zyrat e Thesarit etj.



***Grafiku 3.*** Intensiteti i komunikimeve me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile *(numri i komunikimeve, tema e të cilave është zgjedhur nga bashkitë)*




*Burimi: Co-PLAN & Shoqata për Autonominë Vendore, 2020*

***Grafiku 4.*** Intensiteti i komunikimeve me aktorë të tjerë *(numri i komunikimeve, tema e të cilave është zgjedhur nga bashkitë)*




*Burimi: Co-PLAN & Shoqata për Autonominë Vendore, 2020*


M1 M2 M3 M4 M1 M2 M3 M4 M1 M2 M3 M4 M1 M2 M3 M4 M1 M2 M3 M4 M1 M2 M3 M4 M1 M2 M3 M4
Udhëzime mbi trajtimin e ndihmës ekonomike
Udhëzime për shpërndarje të ushqimit
Bashkëpunim për ngritjen e grupeve vullnetare
Bashkëpunim për transportin e të prekurve
Bashkëpunim për ruajtjen e rendit e qetësisë
Udhëzime në lidhje me ofrimin e shërbimeve
Tjeter


M1 M2 M3 M4 M1 M2 M3 M4 M1 M2 M3 M4 M1 M2 M3 M4 M1 M2 M3 M4 M1 M2 M3 M4
Udhëzime për shpërndarje të ushqimit
Bashkëpunim për ngritjen e grupeve vullnetare
Bashkëpunim për transportin e të prekurve
Bashkëpunim për ruajtjen e rendit e qetësisë
Udhëzime në lidhje me ofrimin e shërbimeve
Tjeter

Përkeqësimi i papritur i situatës lidhur me rritjen e numrit të personave të infektuar dhe masat shtrënguese të vendosura nga qeveria kombëtare kërkuan reagim të menjëhershëm edhe në nivel vendor, gjë e cila u trajtua në planet dhe/ose strategjitë e punës, që synonin menaxhimin e krizës së COVID-19. Në 93.5% të rasteve (43 nga 46 bashki të anketuara) këto plane dhe/ose strategji pune u koordinuan dhe/ose u konsultuan me Agjencinë Kombëtare për Mbrojtjen Civile dhe institucione të tjera në nivel vendor dhe qendror. Rreth 92% (ose 46 nga 50 bashki të anketuara) siguruan se këto plane dhe/ose strategji pune ishin bërë publike dhe mund të aksesoheshin nga qytetarët. Megjithatë, vetëm 51% e bashkive të anketuara (25 nga 49) deklarojnë t'i kenë miratuar realisht këto plane/strategji veprimi me vendim të këshillit bashkiak.

Një prej aspekteve mjaft të rëndësishme në menaxhimin e fatkeqësive është angazhimi i vullnetarëve në ndihmë të personave më të ekspozuar dhe më të prekur. Gjatë muajve të menaxhimi të krizës së COVID-19, 36 nga 50 bashki (72%) raportuan të kishin ngritur ose të kishin mbështetur ngritjen e grupeve vullnetare. Grupet vullnetare u ngritën me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë në 14 nga 34 bashki, të cilat përcaktojnë edhe mënyrën e ngritjes së tyre. Në 1 bashki ngritja u bë me Vendim të Këshillit Bashkiak, ndërsa në 19 bashkitë e tjera nuk pati asnjë vendim. Në një bashki, Këshilli Bashkiak vetëm sa u njoftua për ngritjen e grupit vullnetar dhe aktivitetin e tij. Në disa bashki, vullnetarizmi është mjaft i njohur dhe i përhapur si praktikë (të rinjtë, organizatat e shoqërisë civile, OJF-të, punonjësit socialë, infermierët e papunë, qytetarët etj.), ndërsa në disa bashki të tjera ishte praktikë krejtësisht e re.

Vetëm 37 nga 52 bashki gjithsej ofruan të dhëna lidhur me numrin e vullnetarëve. Shifrat luhaten midis 2-shit, si shifër minimale, dhe 250-ës, si shifër maksimale, me rreth 1,524 vullnetarë në total që bashkëpunuan për realizimin e detyrave të ndryshme dhe me një mesatare prej 41 vullnetarësh për bashki. Sipas raportimeve të 37 bashkive, mosha e vullnetarëve të përfshirë luhatet nga 21 deri në 56 vjeç, ku mosha mesatare është 29 vjeç. Vullnetarët u përfshinë në disa aktivitete dhe u ofruan asistencë kategorive në nevojë të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 236 "Për marrjen e masave të ofrimit të asistencës në banesë ndaj shtresave në nevojë, në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga COVID-19". Këto kategori në nevojë përfshinin: personat me aftësi të kufizuara ose që jetojnë vetëm, të cilët nuk janë në gjendje të kujdesen për veten; familjet/personat e pastrehë; familjet e trajtuara me asistencë sociale dhe që jetojnë në varfëri të skajshme; fëmijët jetimë dhe nënat e vetme; komunitetet Rome dhe Egjiptiane; personat e dëmtuar në aksidente të ndryshme që nuk kanë askënd për t'u kujdesur për ta. Vullnetarët luajtën rol të rëndësishëm kryesisht në dërgimin e pakove ushqimore dhe joushqimore në banesën e personave të kategorive në nevojë, ofrimin e asistencës për personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuar lidhur me pagesat e faturave mujore, vaktet, blerjen e ilaçeve, rimbushjen e telefonave etj. Gjithashtu, vullnetarët i ndihmuan ekipet e bashkisë me identifikimin e familjeve dhe individëve në nevojë, ofruan mbështetje psikologjike dhe i informuan qytetarët rreth emergjencës së COVID-19.

Nga pikëpamja hapësinore, vullnetarët i kanë ofruar shërbimet e tyre brenda territorit të administruar nga bashkia përkatëse (figura 2). Në disa bashki, ndërhyrja e vullnetarëve erdhi si pasojë e kërkesës së posaçme për asistencë. Në përgjithësi, orari i punës së vullnetarëve varej nga shërbimi i ofruar, por zakonisht shtrihej në pjesën e parë të ditës dhe në çdo rast, brenda kufizimeve të vendosura nga qeveria qendrore. Harta e shpërndarjes së vullnetarëve tregon se puna vullnetare u përqendrua në rajonin qendror në Elbasan-Tiranë-Bulqizë; në rajonin verior në Vau i Dejës – Lezhë – Mirditë – Mat – Klos; dhe në rajonin lindor në Maliq-Devoll-Kolonjë. Shifrat nuk përkojnë domosdoshmërisht me numrin e rasteve të infektuara

në territor. Për shembull, të tre bashkitë lindore Vau i Dejës, Klos dhe Bulqizë nuk kanë pasur asnjë rast të infektuar me COVID-19. Nga ana tjetër, Tirana ka numrin më të madh të personave të infektuar.

***Figura 2.*** Vullnetarët që ofruan asistencë në bashki gjatë krizës së COVID-19




*Burimi: Co-PLAN & Shoqata për Autonominë Vendore, 2020*

Krahas vullnetarëve, ka pasur edhe organizata të shoqërisë civile dhe/ose biznese vendore që kanë dhënë mbështetjen e tyre gjatë emergjencës së COVID-19 në rreth 94% të bashkive të anketuara (47 nga 50 bashki). Në përgjithësi, bizneset vendore kanë kontribuar në burime financiare dhe/ose ofrimin e pakove ushqimore dhe joushqimore, të cilat iu shpërndanë kategorive në nevojë nga ekipet e punës të përbëra nga punonjës bashkie dhe vullnetarë. Edhe OSHC të ndryshme, si dhe komuniteti i donatorëve dhanë kontribute (burime financiare, pako ushqimore dhe joushqimore) dhe u angazhuan në shpërndarjen e tyre kategorive në nevojë në mënyrë të drejtpërdrejtë. Ka pasur edhe profesionistë si infermierë, psikologë dhe punonjës bashkie që kanë luajtur rol të rëndësishëm gjatë krizës, nën menaxhimin e ekipit të bashkisë.

## *2.3 Reagimi në nivel bashkie: masat dhe veprimet e ndërmarra dhe/ose të mbështetura në nivel vendor*

Pati një sërë pyetjesh rreth reagimit në nivel bashkie ndaj emergjencës së COVID-19, të cilat synonin të hidhnin dritë mbi rolin dhe masat e ndërmarra nga qeveritë vendore në Shqipëri në mbështetje të qytetarëve të tyre, bazuar në udhëzimet e lëshuara nga institucionet qendrore.

Të gjendur përballë emergjencës së jashtëzakonshme, reagimi në nivel baskie u materializua në plane dhe/ose strategji pune për 51 bashki të anketuara, në koordinim të plotë me Njësitë e Mbrojtjes Civile në Prefekturat përkatëse. Afro gjysma e këtyre bashkive e miratuan planin dhe/ose strategjinë e punës me Vendim të Këshillit Bashkiak. Përmbajtja e planit dhe/ose strategjisë së punës përfshinte, mes të tjerash:

- Identifikimin e kategorive të cenueshme në koordinim me qeverinë qendrore, njësitë e shërbimeve sociale pranë bashkive përkatëse, administratorët e njësive administrative, kërkesat dhe raportimet e qytetarëve, përcaktimin e numrit të gjelbër përë thirrje tekefonike dhe raportimin në platformën e bashkëqeverisjes.[13]
- Furnizimin dhe shpërndarjen e pakove ushqimore: (i) pakot ushqimore u financuan nga fondi bashkiak për emergjencat civile dhe burime të tjera, rezerva e shtetit, komuniteti i biznesit dhe individë; (ii) shpërndarja e tyre u krye nga stafi administrativ i bashkisë përkatëse, administratorët e njësive administrative, vullnetarët dhe kryepleqtë e fshatit.
- Dezinfektimin e rrugëve dhe hapësirave publike në 51 bashki, që u krye nga Shoqëritë e Shërbimeve Komunale/Njësitë e Punëve Publike, Njësitë e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, ose nga shoqëritë e kontraktuara për menaxhimin e mbetjeve në bashki.
- Sigurimin e zbatimit të karantinës, përmes monitorimit të vazhdueshëm të policisë bashkiake, që plotësonte punën e forcave të policisë së shtetit. Ofrimin e informacionit dhe këshillimit të qytetarëve për t'u siguruar që rregullat e distancimit social po zbatoheshin në subjekte tregtare, apo në hapësira të tjera publike.
- Kontrollin dhe monitorimin e tregjeve për ruajtjen e distancës midis njerëzve, për të shmangur grumbullimin përmes: vendosjes së shenjave vertikale ose horizontale, ose vendosjes së orareve për hapjen e tregjeve; kufizimin e tregtisë vetëm brenda zonës së tregut; vendosjes së tuneleve dezinfektuese; monitorimit të zbatimit të orarit të punës; dhe bindjen e tregtarëve për afishimin e posterave për përdorimin e maskave dhe dorezave mbrojtëse njëpërdorimëshe.
- Identifikimin dhe raportimin e rasteve të mundshme të infektuara brenda territorit të bashkisë dhe raportimin e strukturave përgjegjëse. Monitorimin e emigrantëve të kthyer, veçanërisht të atyre që ktheheshin nga vende tejet të prekura, si dhe dezinfektimin e banesave të tyre dhe të zonave përreth njerëzve/familjeve të infektuara.
- Monitorimin e banorëve të cenueshëm ose të prekur në zonat e rrezikuara nga fatkeqësitë natyrore si rrëshqitje dheu, përmbytje etj. përmes strukturës vendore përgjegjëse për mbrojtjen civile. Gjatë periudhës së raportimit, nuk u shënua asnjë ngjarje e fatkeqësive të tjera natyrore në asnjë bashki.

13. https://shqiperiaqeduam.al/#notalme

Bashkitë konfirmojnë se nuk kanë luajtur asnjë rol në transportimin e personave të infektuar drejt Tiranës, ndërsa vetëm bashkia Tiranë raporton të ketë zhvilluar fushatë informimi dhe ndërgjegjësimi për COVID-19.

Të 52 bashkitë e anketuara i dezinfektuan të gjitha hapësirat dhe objektet në territoret e tyre përkatëse (grafiku 5). Më konkretisht, të gjitha bashkitë dezinfektuan zyrat e bashkisë, rrugët, trotuaret, parqet dhe kopshtet. Mbi 90% e të anketuarve dezinfektuan qendrat shëndetësore, këndet e lojërave, kopshtet, shkollat nëntëvjeçare dhe objekte të tjera si mjediset e Ujësjellësit dhe të Njësisë për Mbrojtje nga Zjarri dhe Shpëtim, zyrat postare, stadiumet, shkollat, mjediset e bizneseve vendore, Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë (OSHE), automjetet e transportit publik, arkat etj. Mbi 75% e të anketuarve konfirmojnë të kenë dezinfektuar çerdhet, shkollat profesionale, godinat ku jetojnë personat e prekur, muzetë dhe bibliotekat. Hapësirat dhe objektet publike të përmendura më lart janë dezinfektuar mesatarisht në shkallën 95%-100%, ku niveli më i ulët raportohet të jetë 20% nga disa bashki të pakta në numër dhe niveli më i lartë raportohet të jetë 100%.

***Grafiku 5.*** Dezinfektimi i hapësirave dhe objekteve publike




*Burimi: Co-PLAN & Shoqata për Autonominë Vendore, 2020*

Shpërndarja e pakove ushqimore pëër kategoritë në nevojë është një tjetër veprim i rëndësishëm i ndërmarrë nga 50 bashki. Kategoritë në nevojë përcaktohen në Vendimin Nr. 236. Krahas kësaj, bashkitë përfshinë edhe disa kategori të tjera si familjet në kushtet e varfërisë së skajshme, të plagosurit në aksidente, individët në kushte të pafavorshme jetese, pensionistët që jetojnë vetëm, komunitetet rome dhe egjiptiane, nënat e vetme dhe gratë me urdhër mbrojtjeje, fëmijët jetimë dhe në rrezik. Figura 3 paraqet bashkitë që u shpërndanë pako ushqimore kategorive të lartpërmendura.

***Figura 3.*** Shpërndarja e pakove ushqimore sipas njësive administrative

*Burimi: Co-PLAN & Shoqata për Autonominë Vendore, 2020*

Frekuenca e shpërndarjes së pakove ushqimore ndryshon nga bashkia në bashki, duke u shpeshtuar nga një herë në muaj në çdo ditë. Në 56% të bashkive, pakot ushqimore shpërndaheshin çdo ditë dhe në rreth 30% prej tyre shpërndarja kishte frekuencë më të ulët që luhatej nga një herë në gjashtë herë në javë. Rreth 10% e bashkive të anketuara konfirmuan se pakot ushqimore shpërndaheshin një herë në 14 ditë dhe zakonisht vetëm nëse kishte kërkesë nga palët.

***Grafiku 6.*** Kohëzgjatja (majtas) dhe frekuenca e shpërndarjes së pakove ushqimore (djathtas)




*Burimi: Co-PLAN & Shoqata për Autonominë Vendore, 2020*

Shpërndarja e pakove ushqimore zgjati nga 1 deri në 8 javë, deri në datën e kufi të anketimit (grafiku majtas). Në 46% të bashkive, kohëzgjatja e shpërndarjes së pakove ushqimore ishte 6 javë, ndërsa në 30% të bashkive të anketuara ishte 4 javë.

***Grafiku 7.*** Përqindja e bashkive që e zbatuan më shumë se një herë dërgimin e pakove ushqimore për familjet e mbështetura




*Burimi: Co-PLAN & Shoqata për Autonominë Vendore, 2020*

Pakot ushqimore u shpërndanë më shumë se një herë për disa familje të paraqitura në grafikun 7. Bazuar në përgjigjet e 44 bashkive, rreth 44.7% e bashkive u dërguan më shumë se një herë pako ushqimore 25% të familjeve të mbështetura. Rreth 25.1%-50% e familjeve të mbështetura morën pako ushqimore më shumë se një herë në rreth 31.8% të bashkive. Në rreth 20% të bashkive, u janë dërguar disa herë pako ushqimore mbi 50% e familjeve të mbështetura.

## 2.4 Sfidat: shërbimet, financat, cenueshmëria dhe efektet socio-ekonomike

Problemi i parë që hasën bashkitë gjatë emergjencës së COVID-19 ishte plotësimi i nevojave të ngutshme për pako ushqimore dhe joushqimore për t'u ardhur në ndihmë grupeve të cenueshme dhe të pafavorizuara. Për bashkitë nuk ishte aspak e lehtë që të përgjigjeshin me efikasitet dhe në këtë drejtim dolën në pah disa sfida si: burime të pamjaftueshme financiare për të ofruar furnizimin e duhur në pako ushqimore (76% e bashkive të anketuara); identifikimi i banorëve të cenueshëm (39% e bashkive të anketuara); vështirësi në transportimin e pakove ushqimore për shkak të terrenit dhe mungesës së mjeteve të transportit (përkatësisht 54% dhe 41% bashki).

***Grafiku 8.*** Përqindja e bashkive që hasën vështirësi në shpërndarjen e pakove ushqimore për kategoritë në nevojë




*Burimi: Co-PLAN & Shoqata për Autonominë Vendore, 2020*

Lidhur me vlerësimin e rëndësisë së problemit në lidhje me sfidat (grafiku 9) e hasura nga bashkitë, pamjaftueshmëria e mjeteve financiare për të furnizuar pako ushqimore ishte problematika më e mprehtë në 76% të bashkive të anketuara, duke shënuar një mesatare prej rreth 3.36 (vlerësim i bërë nga shkalla 1- më e ulëta deri në shkallën 5-më e larta). Identifikimi i kategorive të cenueshme dhe numri i pakët i punonjësve në dispozicion për dërgimin e pakove ushqimore ishin dy sfidat e tjera më të rëndësishme, të cilat shënuan përkatësisht një mesatare prej 3.31 dhe 3.20. Përkundrazi, sipas raportimeve të bashkive, kushtet atmosferike nuk e penguan aspak shpërndarjen e pakove ushqimore.

Krahas menaxhimit të nevojave të ngutshme të komuniteteve, emergjenca e COVID-19 solli edhe sfida të tjera lidhur me ofrimin e shërbimeve publike, financat vendore dhe brishtësitë socio-ekonomike. Shërbimet publike vendore, të përkufizuara në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", u përmblodhën në një listë (grafiku 10), në mënyrë që bashkitë të jepnin informacion lidhur me vështirësitë që hasën në ofrimin e tyre që prej fillimit të krizës së COVID-19 në Shqipëri.

***Grafiku 9.*** Vlerësimi i sfidave në shpërndarjen e pakove ushqimore




*Burimi: Co-PLAN & Shoqata për Autonominë Vendore, 2020*

***Grafiku 10.*** Numri i bashkive të anketuara që u përballën me sfida në lidhje me ofrimin e shërbimeve gjatë COVID-19




*Burimi: Co-PLAN & Shoqata për Autonominë Vendore, 2020*

Asnjë prej bashkive të anketuara nuk hasi problem lidhur me shërbime të tilla si: mbledhjen e mbetjeve, furnizimin me ujë të pijshëm, mirëmbajtjen e sistemit të trajtimit të ujërave të ndotura, mirëmbajtjen e sistemeve të kullimit dhe ujitjes. Këto funksione vijuan të ushtroheshin krejt normalisht. Mbi 90% e bashkive nuk hasën probleme të rënda në ushtrimin e funksioneve të tyre si: në mirëmbajtjen e rrugëve, mirëmbajtjen e infrastrukturës për baticat, monitorimin dhe mbrojtjen mjedisore, menaxhimin e pyjeve dhe kullotave, mbrojtjen civile (të gjitha aspektet e tjera përveç pandemisë). Në disa raste, kufizimi i lëvizjes dhe përhapja në masë e panikut solli edhe kufizimin e ofrimit të shërbimit.

Nga ana tjetër, në mbi 92.7% të bashkive të anketuara, transporti publik u pezullua që prej fillimit të krizës dhe u vu në dispozicion vetëm të transportimit të stafit mjekësor. Në mënyrë të ngjashme, aktivitetet kulturore dhe mbrojtja e trashëgimisë u pezullua në 95.8% të bashkive. Në disa raste, njësitë përgjegjëse i organizuan aktivitetet kulturore online. Në 83.3% të bashkive të anketuara, puna për mbrojtjen sociale vijoi normalisht. Nga ana tjetër, në 16.7% të bashkive u vërejtën disa pengesa si nevoja për burime shtesë njerëzore për kalimin në shërbime online; ose ndërgjegjësimi i ulët apo refuzimi i të moshuarave për të marrë shërbime në shtëpi, etj. Në mënyrë të ngjashme, në 85% të bashkive që u goditën nga tërmeti, puna për trajtimin e pasojave të tërmetit të 26 nëntorit nuk u ndërpre, ndërsa në 16.7% të bashkive vërehet ende nevoja për pajisjen e familjeve me çadra të përkohshme dhe vlerësimi i dëmeve është pezulluar. Menaxhimi i tregjeve ishte një tjetër shërbim që hasi disa pengesa në rreth 62.5% të bashkive të anketuara, përfshi edhe mbylljen totale apo të pjesshme, ose në rastin më të mirë, përshtatjen e tregjeve të hapura për të funksionuar në përputhje me dispozitat ligjore dhe monitorimin e vazhdueshëm.

Reagimi ndaj krizës së COVID-19 dhe përshtatja e shërbimeve publike vendore me një kontekst krejtësisht të ri kërkonte më tepër burime financiare. Në atë kohë, Këshillat Bashkiakë hartuan buxhetet vendore dhe afatmesme, të cilat u miratuan nga Prefektët dhe u depozituan në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Për shkak të trysnisë së situatës, rreth 55.8% e bashkive të anketuara (ose 29 nga 52 bashki të anketuara) i ndryshuan buxhetet e tyre fillestare, në mënyrë që të rrisnin shpenzimet për mbështetjen e grupeve të cenueshme. Bashkitë morën miratimin e këshillave bashkiakë përkatës për të përdorur fondin e emergjencës dhe çdo fond tjetër shtesë (rialokimi i linjave të buxhetit) për të financuar shpenzimet për shkak të situatës së emergjencës si: blerjen e pakove ushqimore dhe joushqimore, blerjen e tuneleve dezinfektuese për t'u instaluar në hyrjet e tregjeve, mbulimin e kostove shtesë për dezinfektimin e hapësirave dhe objekteve publike, si dhe blerjen e materialeve njëpërdorimëshme për punonjësit.

Krahas alokimeve të buxhetit, 36% e bashkive të anketuara rishikuan edhe paketën fiskale për 2020-n. E megjithatë, rreth 64% (32 nga 50) e bashkive të anketuara nuk bënë ndryshime në paketat e tyre fiskale që janë aktualisht në fuqi. Ndryshimet e paketave fiskale lidheshin kryesisht me:

- përjashtimin e disa kategorive (si p.sh personave me aftësi të kufizuara të trajtuar me pagesë të aftësisë së kufizuar) nga taksa të ndryshme; tarifat e tregut dhe tarifat për përdorimin e hapësirave publike gjatë muajve të emergjencës; tarifat e shërbimeve si ndriçimi, pastrimi dhe gjelbërimi;
- uljen e taksës së pastrimit dhe banesës, si dhe taksës së tokës bujqësore;
- shtyrjen e pagesave për taksat dhe tarifat vendore.

***Grafiku 11.*** Norma e pritshme e mbledhjes së të ardhurave nga burimet e veta kundrejt planit, gjatë katër muajve të parë të 2020-s




*Burimi: Co-PLAN & Shoqata për Autonominë Vendore, 2020*

Bashkitë konfirmojnë të kenë rishikuar politikat fiskale për të stimuluar ekonominë vendore dhe lehtësuar disi barrën fiskale gjatë periudhës së mbikëqyrur. Kjo nënkupton ulje të të ardhurave vendore. Megjithatë, bashkitë pritet të hasin probleme me gjenerimin e të ardhurave, edhe kur politikat fiskale nuk rishikohen, për shkak të aftësisë të ulët paguese të banorëve dhe bizneseve. Bashkitë e anketuara presin të mbledhin mesatarisht 34.1% të të ardhurave të planifikuara nga burimet e veta (taksa, tarifa dhe të tjera) për katër muajt e parë të 2020-s, me një nivel minimal mbledhjeje prej 10% dhe nivel maksimal mbledhjeje prej 90%, siç paraqitet në grafikun 11. Gjatë katër muajve të parë të 2020-s, mbi 80% e bashkive pritet të kenë normë më të ulët mbledhjeje të tarifave për shërbimet publike (pastrim, gjelbërim, ndriçim), tarifën e përdorimit të hapësirës publike, taksën mbi pasurinë e paluajtshme (banesë, tokë urbane, tokës bujqësore), taksën e hotelerisë dhe taksat për tabelat reklamuese (grafiku 12), krahasuar me planin.

***Grafiku 12.*** Bashkitë (%) që priten të hasin probleme në mbledhjen e të ardhurave nga burimet e veta




*Burimi: Co-PLAN & Shoqata për Autonominë Vendore, 2020*

Pritet të hasen probleme me mbledhjen e të ardhurave në të dy kategoritë e taksapaguesve: familje dhe biznese (grafiku 13 dhe 14). Në rastin e familjeve, kufizimet në lëvizje të vendosura nga qeveria qendrore renditet si faktori kryesor që pengon mbledhjen e të ardhurave në të gjitha bashkitë e anketuara. Ndërkohë, 8 bashki sugjerojnë se problemet me mbledhjen e të ardhurave vijnë kryesisht pasi familjet mendojnë se nuk i kanë konsumuar shërbimet e nevojshme vendore (ndriçimi publik, pastrimi dhe përdorimi i hapësirave publike).

***Grafiku 13.*** Faktorët që pengojnë shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore nga familjet




*Burimi: Co-PLAN & Shoqata për Autonominë Vendore, 2020*

Edhe mbledhja e të ardhurave nga bizneset do të jetë e vështirë. Sipas përgjigjeve të bashkive, në shumicën e rasteve, faktori kryesor që fshihet pas refuzimit për të paguar është mbyllja e bizneseve. Rreth 80% e bashkive parashikojnë të hasin probleme me pagesat nga ana e bizneseve lidhur me tarifën e shfrytëzimit të hapësirave publike dhe mbi 70% e tyre e shikojnë mbledhjen e të ardhurave nga disa burime, ku përfshijnë taksën e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit; taksën e përkohshme për infrastrukturën arsimore dhe taksën për banesën dhe tokën bujqësore, si mjaft problematike. Vetëm 28% e bashkive mendojnë se arsyeja që fshihet pas normës së ulët të mbledhjes së të ardhurave është vështirësia e hasur me shlyerjen e pagesave online.

***Grafiku 14.*** Faktorët që pengojnë shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore nga bizneset




*Burimi: Co-PLAN & Shoqata për Autonominë Vendore, 2020*

Krahas sfidave afatshkurtra financiare, bashkitë kanë renditur edhe një sërë pengesash me të cilat ato duhet të përballen për shkak të krizës së COVID-19, që supozohet të kenë efekte të përkohshme negative, të paktën për dy vitet e ardhshme. Mbi 90% e bashkive të anketuara raportojnë se një prej sfidave mbetet ende e pranishme: niveli i zbatimit të taksave vendore dhe mbledhja e të ardhurave të pritshme nga burimet e veta për periudhën 2020-2021 (parashikohet të ketë trend zbritës). Disa bashki raportojnë se tkurrja e të ardhurave vendore pritet të jetë në rreth 50% krahasuar me nivelet e planifikuara.

***Grafiku 15.*** Sfida të tjera afatshkurtra [për t'u] hasur nga bashkitë




*Burimi: Co-PLAN & Shoqata për Autonominë Vendore, 2020*

Së fundi, në kontekstin e burimeve financiare më pak të disponueshme dhe lëvizjes së kufizuar, mbi 75% e bashkive të anketuara konfirmojnë të kenë pasur shumë pak hapësirë për të manovruar me qëllim stimulimin e ekonomisë vendore dhe të bizneseve vendore (veçanërisht sektori i turizmit). Mbi 80% e bashkive shprehen se presin të përballen me rritje të shkallës së papunësisë, numrit të familjeve që kërkojnë ndihmë ekonomike dhe të nivelit të varfërisë. Përkundrazi, shumica e bashkive (70% ose më shumë) nuk i konsiderojnë si sfida domethënëse kthimin në atdhe të shqiptarëve për shkak të karantinës, mosfunksionimin e shkollave profesionale dhe stazhet e humbura me ndikim ekonomik dhe menaxhimin e kontratave ekzistuese për shërbimet vendore (si transporti dhe shërbime të tjera). Për sa i përket rëndësisë së sfidave (grafiku 16), goditja e sektorit të turizmit, mbyllja e bizneseve dhe ulja e taksave vendore janë zgjedhur si sfida të nivelit të parë dhe të dytë (ndaj edhe si më problematiket) nga të paktën 55% e bashkive. Nga ana tjetër, bashkëpunimi me bizneset dhe kontraktorët e shërbimeve publike është zgjedhur si sfidë e nivelit të 4-t dhe 5-të (ndaj edhe më pak problematikja) përkatësisht nga 45% dhe 65% e bashkive.

***Grafiku 16.*** Vlerësimi i sfidave nga shkalla 1- më e rëndësishmja deri te shkalla 5- më pak e rëndësishmja *(frekuenca e çdo sfide bazuar në vlerësimin e bashkive)*




*Burimi: Co-PLAN & Shoqata për Autonominë Vendore, 2020*

## 2.5 Nevojat në të ardhmen

Bashkitë shprehën edhe nevojat e tyre më të rëndësishme për të ardhmen afatshkurtër deri afatmesme (përfshi vitin 2021) lidhur me situatën e emergjencës, për valët e mundshme të rishpërthimit të infeksionit dhe procesin e rimëkëmbjes. U parashtruan 150 nevoja në total, të cilat janë paraqitur në tabelën e detajuar përkatëse në shtojcën 2. Për shkak të mënyrave të ndryshme të formulimit dhe për të analizuar informacionin lidhur me llojet e nevojave dhe numrin e bashkive që zgjodhën një nevojë të caktuar, të dhënat janë organizuar në tetë kategori kryesore si vijojnë:

- Plotësimi i nevojave bazë të familjeve në pako ushqimore dhe barna (si reagim i menjëhershëm) dhe planifikimi i mbështetjes ose sigurimi i financave për mbrojtje sociale dhe ndihmë ekonomike për grupet më të cenueshme;
- Zhvillimi i aktiviteteve për ndërgjegjësimin e komunitetit, angazhimi në ose promovimi i vullnetarizëm dhe përmirësimi i burimeve njerëzore;
- Mbështetja e bizneseve vendore, fermerëve dhe përforcimi i aktiviteteve për zhvillimin ekonomik në përgjithësi;




- Përmirësimi i planifikimit dhe reagimit ndaj Zvogëlimit të Riskut të Fatkeqësive (ZRF) dhe rritja e fondeve përkatëse;
- Rritja e burimeve financiare vendore në përgjithësi dhe investimi në përmirësimin e infrastrukturës;
- Përmirësimi i infrastrukturës së sektorit vendor shëndetësor dhe higjienës në hapësirat dhe objektet publike;
- Shtimi i mundësive për punësim, ofrimi i ndihmës për ata që kanë humbur vendin e punës për të gjetur një vend pune dhe rritja e shkallës së punësimit në përgjithësi;
- Sigurimi i fondeve të donatorëve për të ndihmuar komunitetet vendore.

***Grafiku 17.*** Nevojat e qeverive vendore në të ardhmen afatshkurtër deri afatmesme




*Burimi: Co-PLAN & Shoqata për Autonominë Vendore, 2020*

Nga 150 nevoja, 32% bëjnë pjesë në kategorinë e ofrimit të mbështetjes bazë për familjet e cenueshme dhe përmirësimit të mbrojtjes sociale dhe ekonomike (grafiku 17). Kjo ndiqet nga nevoja për më tepër burime financiare (23%) dhe nevoja për rritjen e fondeve dhe cilësisë teknike për ZRF-në (19%). E megjithatë, lidhur me këtë të fundit, vetëm pak bashki në numër kërkojnë mbështetje për përmirësimin e kapaciteteve teknike dhe ngritjen e bazës së të dhënave, ose ngritjen e sistemeve të paralajmërimit të hershëm, pasi shumica e vënë theksin te nevoja për më tepër burime financiare, të paktën deri në nivelin e parashikuar me ligj. Rritja e aksesit në punësim dhe mbështetja e ekonomisë vendore kanë pikëzim më të ulët (përkatësisht 7% dhe 11%) Prandaj, ndonëse e pranojnë se papunësia, mbyllja e bizneseve vendore dhe dështimi i sektorit të turizmit janë sfida mjaft të rëndësishme (30% nga 305 sfida në total të parashtruara nga qeveritë vendore, kategoritë e të cilave përcaktohen në grafikun 15), kur vjen puna te plotësimi i nevojave, bashkitë kërkojnë të ndërmarrin veprime që përmirësojnë reagimin ndaj emergjencës. Megjithatë, kjo mund të vijë edhe pasi, kur ky pyetësor u ndërmor, pjesa më e madhe e vëmendjes fokusohej te reagimi i menjëhershëm (tek urgjenca) dhe shqetësimi lidhur me burimet vendore financiare.

***Grafiku 18.*** Bashkitë (% ndaj QV-ve të anketuara në total) që përzgjedhin secilën prej kategorive të nevojave




*Burimi: Co-PLAN & Shoqata për Autonominë Vendore, 2020*

Numri i bashkive që përzgjedhin të paktën një herë një nevojë që klasifikohet në njërën prej këtyre tetë kategorive ndjek trend të ngjashëm me incidencën e nevojave për kategori (grafiku 18). Prandaj, 47 nga 48 bashki të anketuara kanë përzgjedhur të paktën një herë mbështetjen bazë për familjet e cenueshme. Kjo ndiqet nga nevoja për më tepër burime financiare (73% e bashkive) dhe nevoja për përmirësimin e ZRF-së (63% e bashkive).

## 3. Diskutimi i gjetjeve

### *3.1 Qeverisja shumënivelëshe*

**Komunikimi dhe bashkëpunimi ndërqeveritar:** Të gjitha bashkitë kanë pasur komunikime të vazhdueshme me institucionet e qeverisë kombëtare gjatë krizës së COVID-19. Megjithatë, komunikimet kanë qenë më të pakta gjatë periudhës janar- shkurt, dhe shumë intensive gjatë pikut të pandemisë në mars dhe prill. Sidoqoftë, shumica e komunikimeve kishin të bënin me ofrimin e udhëzimeve lidhur me aktivitetet në të cilat bashkitë duhet të angazhoheshin dhe në shkëmbimin e informacionit. Vlen për t'u vërejtur se ka pasur një farë bashkëpunimi lidhur me ngritjen e grupeve vullnetare. Nga pikëpamja e bashkëpunimit vertikal, menaxhimi i emergjencës së COVID-19 ishte i centralizuar. Ndonëse bashkitë luajtën rol të rëndësishëm në realizimin e disa detyrave, këto detyra ishin të përcaktuara në nivel qendror. Ndryshe nga ngjarjet e tjera të fatkeqësive natyrore, qasja e drejtuar nga qeveria kombëtare është një nga më tipiket në përballimin e pandemive. Në Shqipëri, kjo zgjidhje lidhet me objektivin e qeverisë për ta mbajtur kurbën e rasteve të infektuara sa më horizontale, në mënyrë që trysnia mbi sistemin shëndetësor publik të ishte sa më e ulët.

Megjithatë, qasja "e gjithë shoqëria" shihet parimisht si më efikase. Kjo qasje sjell përfshirjen intensive të të gjithë aktorëve shtetërorë dhe joshtetërorë, ku bashkitë në veçanti luajnë rol më të rëndësishëm (Schwartz & Yen, 2016). Bashkitë në Shqipëri nuk kontribuuan në çështje të tilla si: transportimi i personave të infektuar; administrimi i rasteve në nevojë për ndihmë mjekësore nga spitalet vendore dhe rajonale; strategjitë vendore për përdorimin e hapësirës publike dhe lëvizshmërisë. Pra, vendimet u morën në rang kombëtar dhe u zbatuan në rang vendor. Efikasiteti i qasjes së zgjedhur mbetet ende për t'u vlerësuar. Megjithatë, nga pikëpamja vendore vlen të theksojmë dy gjetje të rëndësishme: (i) bashkitë nuk ishin të përgatitura dhe nuk kishin strategji apo plane vendore për menaxhimin e shpërthimeve të sëmundjeve infektive, ose të paktën dokumente për ZRF-në ku trajtohen edhe epidemitë/ pandemitë; (ii) zbatimi i një qasjeje të centralizuar ia ngarkon të gjitha përgjegjësitë institucioneve publike [kombëtare]. Në rastin e Shqipërisë, e gjithë përgatitja dhe reagimi ndaj pandemisë ishte përgjegjësi e qeverisë kombëtare dhe e sektorit publik, ndërsa bashkitë ishin në pozicion pritës për të marrë udhëzime dhe urdhra të qeverisë kombëtare për ta menaxhuar pandeminë në mënyrë efikase. Ndonëse qeveria kombëtare ishte ajo që mbajti barrën më të madhe të përgjegjësisë për menaxhimin e kësaj ngjarjeje fatkeqësie, një qasje më efikase do të ishte mobilizimi i të gjithë shoqërisë në përpjekjet bashkëpunuese (Schwartz & Yen, 2016; Bell et al., 2009), duke siguruar kështu një proces të drejtë dhe rezultat cilësor.

**Vullnetarizmi dhe bashkëpunimi me aktorët joshtetërorë:** Bashkitë në Shqipëri mund të ngrenë ose të mbështesin ngritjen e grupeve vullnetare në përputhje me kompetencat që u jep Ligji 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore" dhe Ligji 45/2019, "Për Mbrojtjen Civile", duke iu referuar edhe Ligjit 45/2016, "Për Vullnetarizmin". Megjithatë, mungesa e akteve nënligjore për vullnetarizmin për të tre ligjet e përmendura, ua vështirëson punën bashkive me vullnetarët dhe marrjen përsipër të përgjegjësive për angazhimin e tyre. Sidoqoftë, duke qenë se situata e COVID-19 është komplekse dhe e pazakontë, disa bashki u mbështetën në punën vullnetare të disa organizatave të shoqërisë civile dhe të rinjve për t'u ardhur në ndihmë më të ekspozuarve dhe më të cenueshmëve. Mund të përmenden këtu rastet e bashkëpunimit më Kryqin e Kuq, World vision dhe Caritas, apo edhe OJF lokale. Po ashtu, vendimet e marra nga qeveria gjatë periudhës mars-prill ishin mjaft të dobishme për bashkitë për të lehtësuar disi proceset e mundshme të vullnetarizmit.

Për shembull, më 19 mars 2020, Këshilli i Ministrave miratoi Vendimin Nr. 236 "Për marrjen e masave të ofrimit të asistencës në banesë ndaj shtresave në nevojë, në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga COVID-19". Ndonëse ky vendim nuk ka në fokus vullnetarizmin, ai përcakton mënyrën e ofrimit të mbështetjes në banesë dhe u lejon grupeve vullnetare të marrin pjesë në ofrimin e saj. Të dhënat e raportuara nga bashkitë për vullnetarizmin janë mjaft shpresëdhënëse, por sërish mbeten të ulëta krahasuar me nevojat. Për më tepër, informacioni është asimetrik nga pikëpamja territoriale. Kështu, 15 nga 52 bashki nuk japin të dhëna për numrin e vullnetarëve dhe ndonjëherë numri është aq i ulët, sa angazhohen vetëm 2 vullnetarë për bashki, ndërsa në raste të tjera e tejkalohet shifra 100. Kjo tregon jo vetëm se situata është e ndryshme për qeveri të ndryshme vendore, por edhe se kemi të bëjmë me një perceptim të ndryshëm të vullnetarizmit dhe me mungesë informacioni për nismat e pavarura. Gjithashtu, mund të supozohet se disa bashki bashkëpunojnë më tepër me grupet vullnetare dhe janë më të mirëinformuara mbi punën e tyre, ndërsa disa të tjera janë shumë larg këtyre proceseve.

Krahas kësaj, përveç vullnetarizmit të organizuar, ka pasur edhe disa raste ku bizneset vendore, organizatat e shoqërisë civile, organizatat me bazë komunitare, institucionet e donatorëve dhe profesionistët (infermierët, psikologët etj.) kanë ofruar mbështetje për bashkitë dhe për disa segmente të popullsisë. Bashkitë janë organet më të përshtatshme publike për të pasur informacion mbi këto nisma, veçanërisht për t'i lehtësuar ato dhe për të bashkëpunuar me njerëz që janë në gjendje të ndihmojnë gjatë ngjarjeve të fatkeqësive. Me shumë gjasa, mund të ishte bërë më shumë në këtë drejtim nëse hapat përgatitorë do të ishin hedhur që në periudhën janar-shkurt dhe nëse bashkëpunimit me aktorët vendorë joshtetërorë do t'i ishte kushtuar më tepër vëmendje në rang kombëtar.

**Decentralizimi dhe aftësia ripërtëritëse:** Në Shqipëri, shërbimet e kujdesit shëndetësor janë përgjegjësi e qeverisë kombëtare, ku bashkitë luajnë rol të kufizuar në shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor. Neni 23, Pika 13 e Ligjit Nr. 139/2015 *"Për Vetëqeverisjen Vendore" përcakton kompetencat e bashkive për "ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave të shërbimit shëndetësor parësor dhe zhvillimin e aktiviteteve edukuese e promovuese në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e shëndetit, si dhe administrimin e qendrave e të shërbimeve të tjera në fushën e shëndetit publik, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj"*. Të dhënat financiare (www.financatvendore.al) konfirmojnë se shërbimet e kujdesit shëndetësor ofrohen thuajse vetëm në nivel qendror, ku bashkitë luajnë rol periferik. Kështu, shpenzimet e bashkisë për shërbimet shëndetësore në vitin 2019 arrinin në rreth 0.1% të shpenzimeve totale publike për kujdesin shëndetësor; 0.0031% të shpenzimeve totale të bashkisë dhe në rreth 0.00016% të PBB-së nominale.

Megjithatë, bashkitë luajnë rol të rëndësishëm në zvogëlimin e riskut të fatkeqësive, përfshi edhe sëmundjet infektive dhe risqet biologjike duke trajtuar aspekte të tjera të tilla si: organizimi i grupeve vullnetare; intensifikimi i mbrojtjes sociale dhe shërbimeve të ndihmës ekonomike për grupet e cenueshme; menaxhimi i transportit urban dhe lëvizshmërisë; përmirësimi i ambienteve të hapura publike (rrugë, sheshe dhe parqe) si hapësira për evakuim (kur është e nevojshme), strehim dhe akomodim; mbështetja e bizneseve dhe fermerëve vendorë në mënyrë që ekonomia të mos goditet rëndë nga efektet e ngjarjes së fatkeqësisë; dhe ndërgjegjësimi i qytetarëve dhe komuniteteve në mënyrë që fazat e përgatitjes, reagimit dhe ripërtëritjes të arrihen jo vetëm brenda institucioneve publike, por edhe në nivel shoqërie. Trajtimi i të gjithë këtyre aspekteve do të mundësojë aftësinë ripërtëritëse të bashkive dhe palëve vendore të interesit.

Aktualisht, aftësia ripërtëritëse në nivel vendor është e dobët në Shqipëri për shkak të faktorëve institucionalë, financiarë dhe teknikë. Fillimisht, qeverive vendore u mungojnë

departamente të forta e të përgatitura lokale të mbrojtjes civile (si në lidhje me numrin e punonjësve, ashtu edhe kapacitet teknike) dhe burime financiare të bollshme (fondi i emergjencës dhe shpenzimet për aftësinë ripërtëritëse). Së dyti, bashkitë nuk zotërojnë dokumentet lokale të veprimeve për zvogëlimin e riskut si: vlerësimet e integruara vendore të riskut, strategjitë për zvogëlimin e riskut të fatkeqësive dhe planet e emergjencës civile. Këto dokumente duhen mbështetur financiarisht dhe shpenzimet përkatëse për to duhen parashikuar në buxhetet vjetore dhe afatmesme. Së treti, deri tani, koordinimi horizontal mes drejtorive të bashkive për mundësimin e aftësisë ripërtëritëse vendore, ka munguar ose ka qenë i dobët. Në përgjithësi, mbrojtja cilive karakterizohet nga një qasje e fragmentuar dhe drejtoritë bashkëpunojnë vetëm në momentin kyç e të vështirë të emergjencës. Së fundi, për momentin nuk ka tendencë për të trajtuar çështjen e aftësisë ripërtëritëse në të gjitha funksionet e shërbimet e bashkisë, e sidomos në ofrimin e infrastrukturave dhe në planifikimin e territorit. Marrja e masave të tilla institucionale dhe ndërgjegjësimi i qytetarëve do t'i vendosnin bashkitë në pozicione drejtuese dhe proaktive, duke garantuar kështu autonominë dhe ndikimin e tyre në menaxhimin e pandemisë.

Financat vendore publike: priten të goditen rënë dhe të pësojnë rënie për periudhën 2020-2021. Dobësitë strukturore të financave vendore publike u vunë re fill pas shpërthimit të pandemisë, ku bashkitë e gjetën veten të papërgatitura për ta përballuar emergjencën. Gjatë emergjencës, bashkitë ishin në vijën e parë të ofrimit të mbështetjes për kategoritë e cenueshme të qytetarëve, për të plotësuar nevojat e tyre bazë në pako ushqimore dhe joushqimore, si dhe për të përshtatur mënyrën e të punuarit lidhur me ofrimin e shërbimeve vendore. Megjithëse kjo e fundit u trajtua (mbi 90% e bashkive konfirmojnë se nuk pati asnjë problem në veçanti, përveç transportit dhe aktiviteteve kulturore të cilat u pezulluan), burimet financiare për të përballuar shtimin e nevojave të komunitetit ishin të pamjaftueshme, veçanërisht për ofrimin e pakove ushqimore dhe joushqimore (konfirmuar nga mbi 75% e bashkive të anketuara). Të gjendur përballë kësaj sfide, me vendim të kështillave bashkiakë, bashkitë filluan të vinin në përdorim fondet e emergjencës, burimet e rialokuara nga linja të tjera buxheti (ose përdorën tepricat nga vitet e mëparshme), si dhe morën kontribute nga donatorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Megjithatë, pas kapërcimit të efekteve të para të krizës shëndetësore, fillojnë efektet e raundit të dytë të krizës që kanë të bëjnë me aspektet ekonomike, sociale dhe financiare, të cilat duhen trajtuar. Ekonomia shqiptare ka pësuar stanjacion dhe parashikimi për të ardhmen nuk është fort optimist, çka do të thotë se aktiviteti i bizneseve është i ulët dhe papunësia në vend është e lartë. Në nivel nënkombëtar, përkeqësimi i situatës ekonomike ka sjellë ndërlikime domethënëse, si financiare, ashtu edhe sociale. Bazuar në raportet e bashkive, norma mesatare e mbledhjes së të ardhurave vendore pritet të jetë rreth 34.1% gjatë katër muajve të parë të 2020-s, krahasuar me të ardhurat e planifikuara, me një nivel minimal prej 10% dhe një nivel maksimal prej 90%. Sipas të dhënave për 2019-n, të ardhurat nga burimet vendore arrinin deri në 31% të totalit të burimeve financiare (Co-PLAN, 2020). Nëse përgjatë vitit 2020 norma e mbledhjes së taksave pritet të jetë 34.1%, bashkitë pësojnë një humbje prej 16.6 miliard lekësh (vlerësuar nga të dhënat për të ardhurat nga burimet e veta të realizuara gjatë 2019-s).[14]

Gjithashtu, rreth 36% e bashkive të anketuara i rishikuan paketat e tyre fiskale të vitit 2020, përfshi edhe masat si, përjashtimet e kategorive të ndryshme nga taksa të ndryshme (veçanërisht ata që jetojnë në kushte të pafavorshme), uljen e tarifave vendore dhe shtyrjen

14. Burimi i të dhënave: www.financatvendore.al

e pagesave për taksat dhe tarifat vendore. Ekziston një lidhje e moderuar reciproke pozitive (52%) midis mbylljes së bizneseve si sfidë për bashkitë dhe hapave të ndërmarrë nga bashkitë për rishikimin e paketave fiskale. Të gjitha këto masa dhe pritshmëri rreth normës së mbledhjes së të ardhurave vendore na çojnë drejt një skenari pesimist për financat e bashkive. Krahas burimeve të veta, burimet e tjera të të ardhurave priten të kenë zhvillim negativ gjatë 2020-s, siç përshkruhet shkurtimisht në tabelën 2.

***Tabela 2.*** Ndikimi financiar i COVID-19 te financat nënkombëtare

| 1. Të ardhura nga burimet e veta | **Negative** |
|---|---|
| *1.1 Taksat* | **Ulje e lehtë**<br>Performanca e të ardhurave nga taksat vendore është përcaktuar nga dy taksa kryesore gjatë tre viteve të fundit: taksa e ndikimit në infrastrukturë (TNI) dhe taksat mbi pasurinë e paluajtshme (TPP). Ndërtimi është një ndër sektorët që u prek më pak nga kriza e COVID-19 dhe të dhënat tregojnë se numri i lejeve të ndërtimit (veçanërisht në bashkinë Tiranë dhe bashki të tjera të mëdha) ka pësuar rritje. Gjatë vitit 2019, nuk pati ndryshime madhore në TPP, ndaj nuk priten ndryshime madhore edhe gjatë vitit 2020.<br>Tatimi mbi fitimin për bizneset e vogla, taksa e fjetjes në hotel dhe taksat e tjera priten të kenë performancë negative gjatë 2020-s. Megjithatë, ky efekt negativ mund të kundërekuilibrohet nga TNI-ja (në disa bashki) dhe nga TPP-ja në të gjitha bashkitë. |
| *1.2 Tarifat dhe detyrimet* | **Negative**<br>Të ardhurat nga tarifat e shërbimeve (tarifa e menaxhimit të mbetjeve, taksa e ndriçimit dhe taksa e gjelbërimit) priten të pësojnë rënie, siç raportohet edhe nga bashkitë e anketuara.<br>Edhe të ardhurat nga përdorimi dhe shfrytëzimi i hapësirave publike priten të pësojnë rënie, ndërsa për tarifat dhe detyrimet e tjera nuk parashikohen ndryshime madhore. |
| *1.3 Menaxhimi i aktiveve* | **Negative**<br>Të ardhurat nga menaxhimi i aktiveve priten të kenë performancë negative. Kjo vjen kryesisht për shkak të pasigurive lidhur me përdorimin e aktiveve dhe dështimin e bizneseve dhe aktiviteteve ekonomike. |
| *1.4 Tarifa të tjera administrative* | Nuk priten ndryshime madhore në tarifa administrative. |
| 2. 2. Transferta të pakushtëzuara | **Nuk ka ndryshime** |
| *2.1 Të përgjithshme* | Nuk ka ndryshime negative dhe sipas komunikimeve të MFE-së, transferta e përgjithshme e pakushtëzuar pritet të rritet edhe në 2020-n, edhe në 2021-shin. |
| *2.2 Sektoriale* | Nuk ka ndryshime negative dhe sipas MFE-së transfertat sektoriale të pakushtëzuara pritet të rriten si në 2020-n, ashtu edhe në 2021-shin. |

| 3. Taksat e ndara | **Negative** |
|---|---|
| *3.1. 225% e të ardhurave nga taksa vjetore e automjeteve të përdorura* | Priten zhvillime negative kryesisht për shkak të të ardhurave më të ulëta nga kjo taksë; |
| *3.2. 97% e taksës mbi të drejtën e kalimit të pronësisë së pasurisë së paluajtshme për individët, personat fizikë dhe juridikë;* | Nuk priten ndryshime madhore, duke qenë se sektori i ndërtimit ka vijuar të funksionojë dhe nuk vërehen ndryshime madhore. Megjithatë, disa të ardhura personale të pakta në numër mund të ndikojnë në kërkesën për ndërtime të reja. |
| *3.3. 5% e të ardhurave nga renta minerale* | Negative, kryesisht për shkak të sinjaleve negative nga tregjet ndërkombëtare. |
| *3.4. 2% e të ardhurave nga taksa mbi të ardhurat personale* | Pozitive, nëse krediti i mbledhur nga taksat nuk është shpërndarë që prej hyrjes në fuqi të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", do të ndahet me bashkitë. Sipas vlerësimit paraprak, shuma prej 1.6 miliard lekësh duhet t'i ishte shpërndarë bashkive gjatë periudhës 2018-2019. Nga ana tjetër, pritshmëritë për TNI-në për vitin 2020 janë negative, pasi kjo taksë lidhet ngushtësisht dhe është tepër e ndjeshme ndaj zhvillimit të përgjithshëm ekonomik, kurba e së cilës duket mjaft pesimiste. |
| 4. Transferta të kushtëzuara | **Nuk ka ndryshime madhore**, nëse qeveria qendrore do të ndjekë të njëjtën politikë lidhur me transfertat sociale dhe investimet (përfshi FZHR-në). |

*Burimi: Co-PLAN & Shoqata për Autonominë Vendore, 2020*

Për ta përmbyllur, bashkitë e anketuara i kanë përdorur të gjitha fondet e emergjencës të planifikuara për vitin 2020, përfshi edhe burimet e veta të disponueshme, si tepricat apo rialokimet e buxhetit. Tkurrja e pritshme e normës së të ardhurave vendore gjatë katër muajve të parë të 2020-s dhe skenari pesimist i zhvillimit ekonomik për pjesën e mbetur të vitit, i vendosin bashkitë në kushtet e cenueshmërisë dhe trysnisë së shtuar për ofrimin e mbështetjes së nevojshme për banorët e tyre. Kjo është shumë e rëndësishme veçanërisht në rast të një vale të dytë të epidemisë së COVID-19 dhe në rast të fatkeqësive të tjera [të mundshme] si përmbytje, zjarre masive dhe tërmete. Në mënyrë të ngjashme, stimulimi i ekonomisë vendore, në kushtet ku papunësia po rritet dhe bizneset po mbyllen, paraqitet si detyrë mjaft sfiduese për bashkitë gjatë pjesë së dytë të vitit 2020 dhe gjatë vitit 2021.

Kapacitetet: fakti se vetëm 8 bashki kanë më pak se 50% të punonjësve të pranishëm në zyrë do të thotë se niveli i përdorimit të teknologjisë për ofrimin e shërbimeve bashkiake online është tepër i ulët dhe se disa bashki të pakta në numër morën vendimin për të ndjekur një qasje më konservatore për të pasur më pak punonjës të pranishëm në zyra me rotacion. Në fakt, këto tetë bashki ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga njëra-tjetra lidhur me madhësinë e popullsisë, ritmin e urbanizimit, specifikat gjeografike dhe kushtet socio-ekonomike. Prandaj, nuk mund të arrihet në përfundimin se këto bashki kanë qenë të përgatitura më mirë krahasuar me të tjerat, lidhur me kapacitetet njerëzore dhe teknologjike për t'iu përgjigjur situatës.

Nga ana tjetër, duke qenë se asnjë bashki nuk ka deri më sot strategji aktuale për ZRF-në dhe plan për emergjencat civile, njohuritë dhe kapacitetet për të menaxhuar emergjencën e fatkeqësisë biologjike ose mungojnë fare, ose në rastin më të mirë, nuk janë të organizuara

sipas një strukture, baze të dhënash apo protokolli. Emergjenca e COVID-19, në mënyrë të ngjashme me tërmetin e 26 nëntorit 2019 nxori në pah nivelin e ulët të gatishmërisë në nivel vendor. Për më tepër, në rastin e COVID-19, duke qenë se përgjigja ndaj emergjencës u drejtua në nivel qendror dhe u fokusua te dy masa kyçe (distancimi social dhe mbajtja e kurbës në nivele horizontale), nuk pati asnjë shtysë që bashkitë të angazhoheshin në strategji të tjera për menaxhimin e pandemisë. Për rrjedhojë, nuk u krijua asnjë trup njohurish dhe nuk iu kushtua vëmendje forcimit të kapaciteteve vendore.

## *3.2 Reagimi në nivel vendor kundrejt faktorëve territorialë*

Kur u pyetën rreth vështirësive lidhur me dërgimin e pakove ushqimore familjeve në nevojë, 20 bashki u përgjigjën se terreni (topografia dhe infrastruktura) dhe mungesa e mjeteve të transportit po e pengonin realizimin e procesit. Ç'është e vërteta, struktura territoriale dhe vendndodhja janë disa prej faktorëve që duhen marrë në konsideratë gjatë përpjekjeve për të kuptuar efektet e shpërthimit të sëmundjeve infektive dhe reagimit përkatës në nivel vendor. Sigurisht që e gjitha kjo shkon përtej vështirësive në aksesimin e ofrimit të disa shërbimeve të caktuara. Duhen analizuar edhe elemente të tjera, veçanërisht për të kuptuar nëse pabarazitë territoriale dhe goditja e reagimi në nivel vendor janë të lidhura me njëra-tjetrën. Përgjigja mund të jetë pozitive jo vetëm kur analizojmë reagimin aktual, por edhe nëse marrim në konsideratë ngjarjet e ardhshme.

Rastet e personave të infektuar me COVID-19, të raportuara nga institucionet zyrtare janë të shpërndara në të gjithë territorin, në 23 bashki, duke e marrë 3 qershorin si datë kufi. Rastet e para të infektuara u raportuan në Tiranë dhe Durrës dhe më pas sëmundja u përhap gradualisht në bashki të tjera. Grafiku 19 dhe figura 4 ofrojnë informacion rreth numrit të personave të infektuar për 10,000 banorë për qeveri vendore të prekur (nuk përfshin humbjet e jetës). Prandaj, ndonëse numrat më të lartë të të infektuarve janë shënuar në Tiranë, Krujë, Shkodër dhe Durrës, bashkia Krujë dallon nga të tjerat me 26 persona të infektuar për 10,000 banorë, ndërsa tre bashkitë e tjera kanë 10 ose më pak raste për 10,000 banorë. Kjo gjë lidhet kryesisht me ndryshimet në popullsi, pasi Kruja ka një popullsi rreth 40% më të vogël se ajo e Shkodrës dhe Durrësit dhe rreth 10% më të vogël se e Tiranës), por mund të lidhet edhe me dinamikat e përhapjes së sëmundjes në secilin territor.

***Chart 19.*** Rastet e infektuara për 10,000 banorë në nivel vendor (pa përfshirë vdekjet), data kufi 3 qershor 2020




*Burimi: Co-PLAN dhe Shoqata për Autonominë Vendore, 2020, bazuar në të dhënat e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Institutit të Shëndetit Publik dhe Open Data Albania.[15] Popullsia nga censusi i INSTAT-it i vitit 2011.*

Në përgjithësi, shifrat ndjekin dy tendenca: (i) përqendrimin e rasteve në zonat më të populluara dhe të urbanizuara të Shqipërisë. Kjo gjë është më se e kuptueshme për shkak të përqendrimit më të lartë të popullsisë, por edhe për shkak se pjesa më e madhe e lëvizjeve ndërkombëtare e kombëtare ndodhin pikërisht në këtë zonë për të gjithë vendin, si edhe sepse e gjithë mbështetja shëndetësore lidhur me emergjencën u ofrua/ofrohet në Tiranë, duke rritur kështu gjasat për infektim. (ii) intensitet më i lartë i infektimeve (raste/10,000 banorë) në bashkitë veriore krahasuar me ato jugore. Kjo mund të vijë për shkak të destinacioneve të emigrimit të popullsisë vendase, që janë të shpërndara përgjatë Evropës, nga Italia deri në Mbretërinë e Bashkuar. Mund të ketë edhe dinamika lokale të tjera, por që duhet të studiohen.

Nga pikëpamja gjeografike, 97% e rasteve të infektuara (pa përfshirë humbjet e jetës) vijnë nga bashki, 75% e popullsisë së të cilave ka jetuar në territore me lartësi deri në 700 m mbi nivelin e detit (grafiku 20). Duhet pasur parasysh se në Shqipëri, 90% e popullsisë së 44 bashkive jeton në territore me lartësi deri në 700 m mbi nivelin e detit, ndërsa vetëm 1.2% e popullsisë së 22 bashkive të shpërndara nga veriu në jug jetojnë në territore me lartësi mbi 1000 m mbi nivelin e detit.

15. http://www.ishp.gov.al/?p=11780; http://open.data.al/covid-19/; https://neë.shendetesia.gov.al/3-qershor-2020-informacion-i-perditesuar-per-koronavirusin-covid-19/.

***Figure 4.*** . Rastet e infektuara për 10,000 banorë në nivel vendor (pa përfshirë humbjet e jetës), data kufi 3 qershor 2020 (majtas)[16] dhe dendësia e popullsisë në banorë për km2 për bashki (djathtas)




*Burimi: Co-PLAN dhe Shoqata për Autonominë Vendore, 2020, bazuar në të dhënat e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Institutit të Shëndetit Publik dhe Open Data Albania; Popullsia nga censusi i INSTAT-it i vitit 2011.*

Struktura territoriale dhe lartësia janë faktorë ndikimi me natyrë të përzier në shpërndarjen e pakove ushqimore. Pakot ushqimore shpërndaheshin 4-7 ditë në javë, gjë që vijoi për më tepër se katër javë për pjesën më të madhe të bashkive që ndodheshin mbi 700 m mbi nivelin e detit (të paktën 50% e territorit të tyre). Megjithatë, në të gjitha këto bashki (20 të tilla) vetëm 50% ose më pak të familjeve në nevojë iu shpërndanë pako për herë të dytë ose më shumë. Kolonja bën përjashtim, pasi 100% të familjeve iu shpërndanë pako për herë të dytë. Në Shqipëri janë 3 bashki me terren malor, ku vetëm 5% e familjeve morën pako për së dyti.

15. Vlora dhe Librazhdi nuk janë në hartë sepse në datën kufi të 3 qershorit 2020 kishin më pak se 0.5 raste për 10,000 banorë.

***Grafiku 20.*** Shpërndarja e popullsisë vendase sipas lartësive mbi nivelin e detit[17]




*Burimi: Co-PLAN dhe Shoqata për Autonominë Vendore bazuar në të dhënat e censusit të INSTAT-it të vitit 2011 dhe hartave të ASIG-ut.*

Për më tepër, të gjitha bashkitë me raste pozitive të COVID-19 kanë pozitë më të mirë nga pikëpamja e aksesueshmërisë krahasuar me ato që nuk kanë pasur raste të raportuara zyrtarisht. Disa bashki, të pakta në numër, si Gjirokastra dhe Pogradeci përbëjnë përjashtim, pasi nuk kanë pasur raste  ndërkohë që pozita e tyre ka qenë e favorshme nga pikëpamja e aksesit të rrugëve kombëtare dhe janë shumë afër me kufirin grek. Aksesi më i mirë në superstrada përkthehet në akses më të shpejtë në shërbimet e kujdesit shëndetësor në Tiranë, që në rastin e mbështetjes shëndetësore të ofruar në nivel qendror, është jetike. Sidoqoftë, kjo gjë nënkupton edhe më tepër komunikime dhe shkëmbime, e për rrjedhojë, më tepër mundësi për ta marrë virusin.

17. Shigjetat në grafik tregojnë bashkitë me raste të infektuara deri më 3 qershor 2020.

## *Grafiku 21.* Ndërmarrjet në nivel vendor për lloj 2018




*Burimi: Co-PLAN dhe Shoqata për Autonominë Vendore bazuar në të dhënat e INSTAT*

Së fundi, në nivel vendor, vlen të vërejmë edhe përkimin nga pikëpamja territoriale midis shpërndarjes së ndërmarrjeve sipas llojit (aktivitetit ekonomik) dhe bashkive me raste të infektuara. Grafiku 21 tregon se, përveç Lushnjës dhe Rrogozhinës, më pak se 45% e ndërmarrjeve në 21 bashkitë e tjera me raste zyrtare të infektuara ishin të fokusuara te bujqësia. Tipologjia e këtyre  bashkive luhatet midis tipologjisë urbane dhe rurale, por në të gjitha bashkitë, 55% e ndërmarrjeve e ushtrojnë aktivitetin në fushën e akomodimit dhe shërbimit ushqimor, ndërtimit dhe shërbime të tjera. Ndërsa sektori i ndërtimit ishte pak a shumë neutral për sa i përket efekteve të COVID-19, turizmi dhe shërbimet ishin sektorët ekonomikë më të prekur, më të cenueshëm dhe më të rrezikuar. Përhapja gjeografike e rasteve të infektuara në Shqipëri tregon se turizmi është prekur qoftë si sektor, qoftë nga pikëpamja territoriale, pasi ndërmarrjet turistike janë të përqendruara në territoret më të prekura.

***Figura 5.*** Infektimet në total (majtas) dhe të infektuarit/10,000 banorë (djathtas) në nivel qarku, 11 qershor, 2020




*Burimi: Co-PLAN dhe Shoqata për Autonominë Vendore bazuar në të dhënat e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Institutit të Shëndetit Publik dhe Open Data Albania; Popullsia nga censusi i INSTAT-it i vitit 2011.*

Në nivel qarku, duke iu referuar datës 11 qershor 2020 si datë kufi, Tirana u rendit e para me numrin më të lartë të të infektuarve në total, ndjekur nga Durrësi me 40% të rasteve të Tiranës dhe Shkodra me 159 të infektuar ose thuajse sa 56% e rasteve të Durrësit. Të gjithë qarqet e tjera kanë numra një ose dyshifrore. Densiteti i infektimeve, pra numri i të infektuarve për 10,000 banorë është më i lartë në qarkun e Durrësit (10), i cili ndiqet nga Tirana dhe Shkodra (8), duke treguar kështu një lloj prirjeje të kundërt krahasuar me vlerat totale, kryesisht për shkak të numrit të lartë të popullsisë së Tiranës dhe përqindjes

së lartë të infektimeve në Shkodër. Megjithatë, tendenca kryesore mbetet e njëjtë në të dy hartat e figurës 5: (i) densiteti më i lartë (densiteti dhe totali) i infektimeve vërehet në zonën metropolitane (Tiranë-Durrës); (ii) përqendrimi i dytë më i lartë vërehet në qarqet veriore (Shkodër, Kukës dhe Lezhë), ku dallimi me zonën metropolitane lidhur me densitetin është relativisht i vogël, pasi edhe popullsia e secilit qark është e vogël; (iii) qarqet jugore kanë përqendrim shumë herë më të ulët për sa i përket densitetit, ndërsa numri i infektimeve në total luhatet nga 64 në Fier deri në 1 rast në Gjirokastër. Në përgjithësi, veriu duket se është prekur më tepër se jugu, ndërsa zona metropolitane qendrore qëndron shumë më lart se dy rajonet e tjera.

Analizat e pabarazive rajonale, të kryera në vitet 2009, 2015 dhe 2019 me mbështetjen përkatësisht të UNDP-së dhe BE-së, GIZ-it, SDC-së dhe ADA-s, dhe SDC-së, kanë arritur gjithnjë në përfundimin se qarqet veriore janë më të pafavorizuarat për sa i përket zhvillimit socio-ekonomik. Zona metropolitane Tiranë-Durrës ka treguesit më të lartë socio-ekonomikë, por ka performancë mjedisore të ulët. Rajonet veriore paraqesin një tablo paksa më të përzier, ku zonat malore dhe rurale janë zakonisht më të pafavorizuara se zonat urbane dhe bregdetare brenda rajonit.

Sidoqoftë, në kuadër të kryerjes së një analize të thjeshtë midis përhapjes së infektimeve të COVID-19, reagimit të bashkive dhe pabarazive territoriale, u vëzhguan pak tregues. Kështu, në kontekstin e rritjes graduale së migrimit të përgjithshëm neto, zonat që kanë shënuar rritje popullsie përgjatë viteve (Tirana dhe Durrësi, grafiku 22) janë ato të prekura më së shumti nga pandemia.

***Grafiku 22.*** Migrimi përgjatë viteve (majtas) dhe ndryshimi i popullsisë për qark (në hyrje dhe dalje, djathtas)







*Burimi: Co-PLAN dhe Shoqata për Autonominë Vendore bazuar në të dhënat e INSTAT*

Për sa i përket numrit të ndërmarrjeve për 1000 banorë, vlerat më të larta janë shënuar në qarqet jugore, ku përhapja e infeksioneve për 10,000 banorë është më e ulët. Situata paraqitet në mënyrë të ngjashme për PBB-në për frymë po të krahasojmë qarqet veriore me qarqet jugore, por në këtë rast, zona metropolitane (Tiranë-Durrës), që ka edhe PBB-në më të lartë për frymë në vend, veçohet si zona e goditur më së shumti (figura 6). Për t'i ardhur në ndihmë bizneseve, të dyja bashkitë (e Tiranës dhe Durrësit) e këtyre dy qarqeve qendrore, përfshi edhe Kavajën dhe Vorën, kanë rishikuar paketat e tyre fiskale, duke shtyrë shlyerjen e taksave dhe tarifave, dhe në rastin e Tiranës, duke i përjashtuar ato nga tarifa e përdorimit të hapësirës publike për muajt mars dhe prill. Bashkitë e këtyre dy qarqeve pritet të mbledhin midis 50% (Durrës) dhe 20% (Tiranë) të të ardhurave të planifikuara nga burimet e veta për katër muajt e parë të vitit 2020.

***Figura 6.*** PBB-ja e qarkut për frymë (majtas, 2017, Euro) dhe numri i ndërmarrjeve për 1000 banorë në nivel qarku 2018 (djathtas)




*Burimi: Co-PLAN dhe Shoqata për Autonominë Vendore bazuar në të dhënat e INSTAT*

Shifrat e punësimit dhe papunësisë në nivel qarku duket se lidhen në mënyrë reciproke me njëra-tjetrën (figura 7), ku katër qarqet fqinje (Lezhë, Dibër, Durrës dhe Tiranë) kanë punësimin më të ulët, duke krijuar kështu një bllok kohesiv krahasuar me qarqet e tjera. 80% e bashkive në këto 4 qarqe e shikojnë punësimin si sfidë madhore jo vetëm gjatë këtyre viteve, por

edhe gjatë viteve të ardhshme. Bashkitë e mëdha në veçanti mendojnë se janë më pranë bizneseve dhe thuajse që të gjitha priten të ulin të ardhurat e tyre për periudhën afatshkurtër deri në afatmesme, si dhe të rrisin numrin e familjeve që marrin ndihmë ekonomike. Për më tepër, të dhënat për sfidat e pritshme në të ardhmen për këto bashki tregojnë se ekziston një lidhje reciproke pozitive midis mbylljes së bizneseve dhe problemeve me kontratat e pezulluara të transportit publik (koeficienti 0.79). Në qarqet jugore, papunësia është e lartë veçanërisht në Vlorë (15.2%), ndjekur nga Fieri me 9.5%. Të gjitha bashkitë përkatëse e shohin rritjen e papunësisë si sfidë afatshkurtër dhe afatmesme të shkaktuar nga COVID-19, ndërsa mbyllja e bizneseve shihet si sfidë kryesisht për bashkitë urbane. Për ta përforcuar këtë gjetje, përveç Lushnjës dhe Selenicës, bashkitë e tjera të anketuara nga këto dy qarqe shprehen se i druhen dështimit të sektorit të turizmit gjatë vitit 2020 dhe 2021.  and 2021.

***Figura 7.*** Punësimi (%, majtas) dhe Papunësia (%, djathtas) në nivel qarku, 2019




*Burimi: Co-PLAN dhe Shoqata për Autonominë Vendore bazuar në të dhënat e INSTAT*

Vëzhgimi i fundit ka të bëjë më shërbimet, veçanërisht me kujdesin shëndetësor (kapacitetet e spitaleve në shtretër) dhe furnizimin me ujë (figura 8). E para ofrohet nga qeveria qendrore ndërsa e dyta nga qeveritë vendore. Shërbimet janë tejet të rëndësishme sidomos kur gjendemi përballë ngjarjeve të fatkeqësive, përfshi edhe fatkeqësi biologjike dhe sëmundjet infektive. Trajtimi mjekësor i specializuar për emergjencën e COVID-19 u ofrua nga dy spitale

në Tiranë, ku spitalet rajonale u përfshinë shumë pak, për të mos thënë aspak. Për shkak të dinamikës së numrit të popullsisë, numri i shtretërve në spitale për 10,000 banorë ishte më i ulët në qarqet bregdetare e në Berat, dhe më i lartë në qarqet lindore, nga veriu në jug. Figura 8 tregon tendencën vertikale gjeografike të shpërndarjes së këtij treguesi jashtëzakonisht të rëndësishëm për reagimin parësor ndaj ngjarjeve të fatkeqësive të ndryshme. Pavarësisht veçorive territoriale, treguesi tregon se ekziston një potencial që duhet shfrytëzuar në të ardhmen.

***Figura 8.*** Shtretërit në spitale për 10,000 banorë, 2016 (majtas); sasia e ujit të prodhuar për person të furnizuar, 2017 ($m^3$) (djathtas)




*Burimi: Co-PLAN dhe Shoqata për Autonominë Vendore bazuar në të dhënat e INSTAT*

Ky model vertikal i shpërndarjes territoriale të vlerave të treguesit vërehet edhe në furnizimin me ujë (ndonëse i pasqyruar krahasuar me shtretërit në spitale) ku sasia e ujit të prodhuar për person të furnizuar ishte më e lartë në qarqet bregdetare e në Berat dhe shumë më e ulët në qarqet lindore nga veriu në jug. Kjo gjetje është mjaft pozitive për zonën bregdetare, e cila ka përqendrim të konsiderueshëm të popullsisë. Sidoqoftë, vlerat e ulëta të qarqeve malore nuk janë pozitive, sidomos po të supozojmë se në rast evakuimi (për shembull në ngjarje që lidhen me ndryshimet klimatike) këto janë qarqet që do të presin popullatën e evakuuar.

# 4. Përfundime dhe Rekomandime

## *4.1 Përfundime*

Nga analiza e të dhënave të anketimit të përgjithshëm, të kryer me bashkitë mbi reagimin e tyre ndaj emergjencës së COVID-19, u arritën një sërë përfundimesh lidhur me qeverisjen dhe decentralizimin, ndërlikimet financiare, aftësinë ripërtëritëse dhe mbrojtjen civile, planifikimin hapësinor dhe shërbimet.

**Decentralizimi dhe drejtimi në nivel vendor:** Në Shqipëri, emergjenca e COVID-19 u menaxhua dhe po menaxhohet ende përmes një qasjeje të centralizuar, ku procesi drejtohet nga Kryeministria dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Zbatimi i masave izoluese filloi në fillim të marsit 2020 dhe hapja graduale nisi në fillim të majit për të vazhduar deri më sot (qershor 2020) Kujdesi shëndetësor për personat e shtruar u ofrua në dy spitale në Tiranë. Aktualisht, sipas përkufizimit në ligj, kujdesi shëndetësor është funksion që ushtrohet thuajse plotësisht nga qeveria qendrore. Qeveritë vendore janë përgjegjëse për shërbimet (godinat) e kujdesit shëndetësor parësor, të cilat sidoqoftë nuk u përdorën për qëllimet e emergjencës, por vetëm për këshillim.

Për një vend të vogël si Shqipëria, centralizimi i kujdesit shëndetësor gjatë fatkeqësive biologjike mund të jetë në parim zgjidhje efikase. Por, decentralizimi territorial (dekoncentrimi – trajtimi në spitale rajonale) mund të kishte qenë më efikas në terma të përgjithshëm. Ndonëse kostot e trajtimit do të kishin qenë më të larta, shpejtësia e gjurmimit të rasteve, ofrimit të trajtimit dhe e kujdesit do ta kishin ulur e sheshuar më shumë kurbën dhe do ta kishin ndërprerë transmetimin në komunitet. Sigurisht që vetëm epidemiologët janë në pozita për të bërë saktësisht vlerësime të tilla, por mungesa e qasjes së decentralizimit i lë qeveritë vendore jashtë menaxhimit të pandemisë, duke ua hequr përgjegjësitë që kanë lidhur me këtë proces, duke ulur ndjeshëm llogaridhënien ndaj komuniteteve dhe duke i lënë në pritje ose në pozicion reaktiv.

Qeveritë vendore reaguan kundër emergjencës në periudhën mars-prill kryesisht duke ndërgjegjësuar komunitetet vendore për risqet e sëmundjes dhe masat e higjienës; duke dezinfektuar hapësirat publike, tregjet, godinat publike dhe objekte të tjera jopublike ku pati raste infektimesh; duke identifikuar grupet e cenueshme të qytetarëve dhe duke i furnizuar ata me pako ushqimore dhe joushqimore; si dhe duke monitoruar lëvizshmërinë dhe qarkullimin në hapësira publike, në hyrje dhe dalje të qyteteve, duke ruajtur kështu rendin dhe sigurinë. Drejtimi në nivel vendor u kufizua vetëm në këto aktivitete dhe mundet vetëm ta supozojmë, por është e vështirë të vlerësojmë nëse roli që mund të kishin luajtur në menaxhimin e krizës do ta kishte përmirësuar efikasitetin e procesit, duke sjellë kështu edhe rezultatin e dëshiruar.

**Qeverisja shumënivelëshe dhe angazhimi qytetar:** Qasja e centralizuar e menaxhimit të pandemisë e kufizon bashkëpunimin shumënivelësh në komunikimin, informimin dhe zbatimin e zinxhirit të komandave. Në Shqipëri, ky ka qenë rasti me bashkëpunim vertikal, që u karakterizua nga komunikimet midis MSHMS-së, Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Policisë së Shtetit, Prefekturave në njërën anë dhe bashkive e strukturave përkatëse vendore publike nga ana tjetër. Megjithatë, në rrafsh horizontal, ka pasur edhe angazhim qytetar përmes vullnetarëve vendorë, që në disa raste u organizuan në struktura specifike dhe në raste të tjera vepruan krejt individualisht, por gjithnjë në koordinim me qeveritë përkatëse vendore. Në parim, qeveritë vendore jo vetëm që mund, por janë edhe shumë të përshtatshme për të promovuar dhe zbatuar bashkëpunimin shumënivelësh për menaxhimin e emergjencave në rast fatkeqësish brenda territorit të tyre, për shkak të afërsisë me

komunitetet. Megjithatë, në fatkeqësitë biologjike, përfshirja e vullnetarëve mund të jetë edhe e kufizuar (në numër dhe në lloje aktivitetesh) për shkak të rrezikut të transmetimit të infeksionit. Vullnetarët i ndihmuan bashkitë në Shqipëri me dërgimin e pakove ushqimore dhe joushqimore, si dhe me aktivitetet ndërgjegjësuese. Në përgjithësi, për shkak si të qasjes së centralizuar, ashtu edhe të natyrës së fatkeqësisë, qeverisja shumënivelëshe ishte tejet e kufizuar gjatë emergjencës së COVID-19 në Shqipëri.

**Aftësia ripërtëritëse dhe mbrojtja civile:** Qeveritë vendore në Shqipëri nuk janë të mirëpërgatitura për të përballuar emergjencat në raste fatkeqësish për shkak të mungesës së burimeve njerëzore, teknike dhe financiare. Ato kanë më tepër njohuri për rreziqet natyrore dhe risqet e fatkeqësive, dhe më pak për fatkeqësitë biologjike. Që prej muajit gusht 2019, bashkive iu ngarkua zbatimi i ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile", i cili është një përmirësim i konsiderueshëm për sa i përket objektit dhe fushëveprimit, duke e zgjeruar nocionin e emergjencës civile në mbrojtje civile dhe duke përqafuar konceptin e aftësisë ripërtëritëse. Ligji i kërkon bashkive që të përgatisin dokumentet për vlerësimin e integruar të riskut, strategjitë e zvogëlimi të riskut dhe planet e emergjencës civile. Këto dokumente do të miratohen nga këshillat vendorë brenda dy vitesh nga data e miratimit të ligjit (pra brenda muajit korrik 2021), por deri më tani vetëm bashkia e Lezhës ka nisur nga puna për përgatitjen e këtyre dokumenteve përmes qasjes me pjesëmarrje të komuniteteve dhe aktorëve.

Vështirësia më e madhe që haset në përgatitjen e dokumenteve të mbrojtjes civile ka të bëjë me mungesën e bazave vendore të të dhënave, informacioneve të hollësishme dhe në seri kohore. Megjithatë, bashkitë kanë njohuri përmes ekspertëve vendorë dhe zbatimi i vlerësimit të riskut përmes pjesëmarrjes mund ta zëvendësonte në nivel të pranueshëm mungesën e bazave shkencore të të dhënave, të paktën për periudhën afatshkurtër deri afatmesme. Nga ana tjetër, qasja pjesëmarrëse mund të mos mjaftojë për përgatitjen ndaj risqeve të fatkeqësisë biologjike. Sigurisht që nga qytetarët mund të merret informacion në çdo kohë dhe ndërgjegjësimi në nivel vendor mbetet aktiviteti kryesor i zvogëlimit të riskut të fatkeqësive përmes pjesëmarrjes, por reagimi i kujdesit shëndetësor lidhet ngushtësisht me rolin e institucioneve të specializuara dhe qeverinë kombëtare. Në këto rrethana, bashkitë në Shqipëri ishin të papërgatitura për ta përballuar emergjencën, dhe për më tepër, atyre iu dhanë role tejet të kufizuara. Në shumicën e rasteve, entet përgjegjëse për drejtimin e procesit të reagimit në nivel bashkie dhe të komunikimit me institucionet e qeverisë vendore ishin kryetarët e bashkive dhe strukturat e mbrojtjes civile (departamentet, ose edhe specialistët individualë).

Së fundi, ka ende vend për diskutim nëse qasja e centralizuar dhe elitiste e ndjekur nga qeveria shqiptare është më efikase se qasja demokratike komunitare ndaj menaxhimit të emergjencës së fatkeqësisë biologjike. Ky lloj vlerësimi mbetet ende për t'u realizuar, por mund të themi me plot siguri se gjatë periudhës së izolimit pati mjaft ndërlikime etike dhe morale. Për më tepër, vetë demokracia është vënë në pikëpyetje gjatë menaxhimit të pandemisë, edhe në rang ndërkombëtar. Ndonëse qasja e centralizuar dhe masat shtrënguese izoluese mund të shihen si më efikase lidhur me kontrollin e sëmundjes dhe shmangien e gabimeve në informim, qasja komunitare do të sillte respektimin e lirive njerëzore dhe të dinjitetit njerëzor, si dhe ekuilibrim më të mirë midis demokracisë, vlerësimit të riskut dhe reagimit, dhe saktësisë së informacionit.

**Ndërlikimet financiare:** Financat e bashkive do të preken rëndë për periudhën afatshkurtër dhe afatmesme pas emergjencës së COVID-19 gjatë gjysmës së parë të 2020-ës. Priten trende negative ose zbritëse. Pritet të ketë tkurrje thuajse në të gjitha kategoritë e të ardhurave:

burimet e veta (taksa, tarifa dhe të tjera), taksa të ndara dhe grante të kushtëzuara. Transfertat e pakushtëzuara (si të përgjithshme, ashtu dhe sektoriale) priten të mbeten së paku në të njëjtin nivel me vitin pararendës. Fondi i emergjencave u shpenzua pjesërisht ose totalisht gjatë muajve të izolimit, së bashku me fondet nga rialokimet e buxhetit dhe tepricat, duke konsumuar kështu të gjitha kapacitetet e brendshme për t'u përballur me ngjarjet që priten në gjysmën e dytë të 2020-s. Deri më sot, qeveria qendrore nuk ka ofruar asnjë mbështetje shtesë për qeveritë vendore për të kapërcyer hendekun negativ midis nevojës për të bërë shpenzime dhe kapacitetit për të gjeneruar të ardhura. Në këto kushte, qëndrueshmëria financiare e bashkive është në pikëpyetje të madhe dhe vazhdimësia e ofrimit të shërbimeve publike nuk mund të garantohet, të paktën për investimet.

**Planifikimi hapësinor dhe shërbimet publike:** Bashkitë raportojnë se gjatë muajve mars dhe prill 2020 u ofrua shumica e shërbimeve publike, përveç transportit publik dhe aktiviteteve kulturore. Këto dy të fundit u pezulluan në nivel kombëtar. Disa bashki i ofruan shërbimet e tyre online (në shkallën më të lartë të mundshme) Monitorimi rutinë i mirëmbajtjes dhe funksionimit të disa shërbimeve publike vijoi normalisht. Gjatë muajve në vijim, situata pritet të jetë mjaft sfiduese për shkak të tkurrjes financiare dhe pakësimit të të ardhurave vendore nga burimet e veta.

Për sa i përket planifikimit hapësinor, aktivitetet e qeverive vendore u fokusuan te dhënia e lejeve të ndërtimit. Ky shërbim kryhet online përmes një sistemi që ka tre vite tashmë që është funksional. Meqenëse sektori i ndërtimit nuk u prek në mënyrë të konsiderueshme, dhënia e lejeve të ndërtimit vijoi normalisht. Megjithatë, ndonëse aktivitetet për zhvillimin e tokës vijuan, nuk pati asnjë ndryshim të planifikimit hapësinor për t'u përshtatur me situatën. Një problem madhor në zonat urbane ishte densiteti i ndërtesave dhe popullsisë dhe mungesa e hapësirave të hapura publike të mjaftueshme për të akomoduar disa persona njëherësh.
Në fakt, planifikimi dhe projektimi urban i qyteteve në Shqipëri nuk i ka marrë aspak në konsideratë risqet e fatkeqësive biologjike deri më tani. Për shembull, komunitetet në zemër të zonave urbane mund t'i aksesojnë lehtësisht tregjet duke ecur në këmbë, por nuk kanë mjaftueshëm mjedise të hapura dhe u detyruan të qëndronin për një kohë mjaft të gjatë të mbyllur në shtëpi. Komunitetet më në periferi ishin më të favorizuara për sa i përket aksesit në hapësira të hapura, por e kishin shumë të vështirë të ecnin drejt tregjeve për shkak të distancës, ndërkohë që përdorimi i makinave ishte ndaluar. Në njëfarë mënyre, avantazhet dhe disavantazhet e të jetuarit në pjesë të veçanta të qytetit ishin rezultat i distancës, densitetit dhe shpërndarjes së shërbimeve në territor, të përcaktuara nga tregu dhe jo përmes planifikimit strategjik dhe vendimeve për zhvillimin e territorit. Mund të themi se qytetet në Shqipëri ishin të papërgatitura për ta përballuar emergjencën e shpërthimit të sëmundjes infektive, si për sa i përket sipërfaqeve/prezencës së hapësirave të hapura, ashtu dhe funksioneve në territor.

**Pabarazitë territoriale dhe risqet e fatkeqësisë:** Zona më e prekur për sa i përket numrit të personave të infektuar ishte zona metropolitane Tiranë-Durrës, gjë që lidhet dukshëm me: (i) ritmin e lartë të urbanizimit dhe densitetin e lartë të popullsisë; (ii) shkëmbimet intensive në njerëz dhe mallra; (iii) qarkullimin e lartë si pasojë e rolit që luajnë si qendra për udhëtime ndërkombëtare; (iv) dhe vendndodhjes së spitaleve të specializuara që ofruan dhe po ofrojnë ende trajtim dhe mbështetje shëndetësore për të gjithë qytetarët pozitivë me COVID-19. Prandaj, në njëfarë mënyre, këta faktorë që përmirësojnë aksesueshmërinë territoriale dhe nxisin rritjen ekonomike të një rajoni, mund të shndërrohen fare lehtë në faktorë për përkeqësimin e situatës gjatë emergjencës të shkaktuar nga një fatkeqësi biologjike. Situata përkeqësohet më tej nga faktorë mjedisorë si ndotja e ajrit dhe hapësirat e gjelbra të pamjaftueshme.

Nga ana tjetër, edhe rajonet e konsideruara si të pafavorizuara për shkak të pabarazive socio-ekonomike (qarqet veriore dhe zonat malore rurale) u goditën më tepër nga pandemia se qarqet e tjera joqendrore. Shkodra në veri është qarku i tretë më i prekur për nga numri i personave të infektuar, ndërsa Kukësi dhe Lezha zënë përkatësisht vendin e katërt dhe të pestë për nga densiteti i infektimeve për 10,000 banorë. Sipas INSTAT (2018), Kukësi dhe Lezha kanë pasur normën më të lartë të varësisë moshore për të rinjtë dhe të moshuarit në Shqipëri. Të tre qarqet kanë PBB-në më të ulët për frymë, ndërsa Kukësi e Lezha kanë pasur edhe numrin më të ulët të ndërmarrjeve për 1000 banorë. Në mënyrë të ngjashme, papunësia është e lartë dhe aksesueshmëria është e ulët (përveç se në zonat urbane të Shkodrës dhe Lezhës, në ultësirë).

Analiza e pabarazive territoriale duhet interpretuar me kujdes dhe nevojiten më tepër tregues për të paraqitur një tablo sa më të plotë. Megjithatë, ky dokument bazohet edhe në studime të mëparshme të pabarazive territoriale, që nxjerrin në pah tendencën për zonat e pafavorizuara dhe të favorizuara gjatë 11 viteve të fundit, pra që prej vitit 2009. Vlerësimi aktual tregon se zonat më të pafavorizuara rrezikojnë të vuajnë më tepër nga pandemia, dhe këtu nuk i referohemi vetëm aspekteve shëndetësore të COVID-19, por edhe efekteve socio-ekonomike për periudhën afatshkurtër dhe afatmesme.

## *4.2 Rekomandime*

Emergjenca e shkaktuar nga COVID-19 është ende e pranishme. Situata ka ndryshuar gjatë muajve maj dhe qershor me hapjen graduale të ekonomisë dhe jetës sociale, por edhe me rritjen e ndjeshme të numrit të personave të infektuar. Mbetet ende e paqartë se cili dhe kur do të jetë piku gjatë sezonit të verës 2020, si dhe se cilët janë skenarët që mund të presim në vjeshtë dhe dimër. Izolimi dhe mbyllja e ekonomisë duhen shmangur, përndryshe fatkeqësia socio-ekonomike e shkaktuar nga këto masa do t'i kapërcente shumëfish përfitimet shëndetësore që ato mund të kenë. Por, sigurisht që rritja e kurbës nuk është lajm i mirë dhe qeveria duhet të mendojë herët a vonë për rishikimin e strategjisë së saj, që të përfshijë në mënyrë domethënëse edhe qeveritë e aktorët vendorë.

Në nivelin e reagimit të menjëhershëm, duke qenë se ndërgjegjësimi për higjienën personale dhe kujdesin janë më të rëndësishmet për parandalimin e marrjes dhe transmetimit të virusit, qeveritë duhet të angazhohen në mënyrë aktive në këto aktivitete. Kjo duhet ndjekur nga monitorimi i shpeshtë e nga afër i hapësirave publike, tregjeve dhe zonave të tjera ku prania e publikut është e pashmangshme, për të detyruar përdorimin e masave parandaluese, si maskat dhe distancimi social.

Qeveritë vendore duhet të vazhdojnë të angazhohen edhe në dezinfektimin e hapësirave dhe objekteve publike, si dhe të sigurohen se mjetet e transportit publik (kur të nisë funksionimi) të mbahen të pastra dhe të mos mbipopullohen. Bashkitë duhet të fillojnë të ngrenë, ose të fillojnë të përmirësojnë sistemet tashmë të ngritura të ofrimit të shërbimit online, si dhe të shmangin kontaktin e drejtpërdrejtë me qytetarët sa më shumë të jetë e mundur. Bashkitë duhet të përgatiten seriozisht për vitin e ri shkollor që fillon në shtator-tetor, duke përmirësuar infrastrukturën përkatëse për të garantuar hapësirë, ajrosje, kushte të përshtatshme dhe dezinfektim.

Për rezultate afatmesme deri afatgjata të cilat shkojnë përtej pandemisë aktuale, qeveritë vendore duhet të nisin menjëherë përgatitjen e dokumenteve të tyre strategjike (vlerësimin e riskut, strategjitë për ZRF-në, dhe planet e emergjencës civile), të cilat duhet të përfshijnë

edhe fatkeqësitë biologjike. Po ashtu, ato duhet të fillojnë paralelisht të rishikojnë planet e tyre të territorit për të përfshirë ato elemente fizike të formës dhe hapësirës së qytetit të cilat:

- garantojnë lëvizjen këmbësore kudo në qytet, në qendër apo periferi;
- përmirësojnë aksesin në të gjitha qendrat e qytetit, si përmes transportit publik, ashtu edhe mjeteve individuale të motorizuara, për të garantuar mundësi dhe alternativa të barabarta për të gjithë në çdo kohë dhe pavarësisht trysnisë së ushtruar nga rreziku;
- rrisin sasinë dhe cilësinë e mjediseve të hapura publike, veçanërisht të zonave të gjelbra dhe parqeve në çdo lagje;
- zëvendësojnë gradualisht transportin aktual me mjete që emetojnë shumë më pak ose aspak karbon;
- nxisin/motivojnë tregun për përhapjen/tregtimin e makinave me emtime shumë të ulëta të karbonit dhe/ose elektrike, përfshirë rritjen e numrit dhe shpeshtësinë e stacioneve të karikimit;
- përmirësojnë shpërndarjen e shërbimeve me interes të përgjithshëm (në rastin konkret të dyqaneve dhe farmacive) në të gjitha lagjet, të aksesueshme përmes levizjes në këmbë.

Rishikimi i mësipërm i planeve duhet përkthyer menjëherë në projekte konkrete për zbatim. COVID-19 është një gur kilometrik në historinë e botës dhe kjo goditje duhet t'i shërbejë komuniteteve dhe njerëzimit si përvojë syçelëse. Çdo akt për mirëqeverisjejen e qytetit ka rëndësi.

Për më tepër, burimet financiare kanë rëndësi parësore në çdo veprim që bashkitë ndërmarrin për t'u përballur me emergjencën dhe efektet e vazhdueshme të COVID-19. Për t'i zbutur trysnitë që rëndojnë mbi qëndrueshmërinë financiare të bashkive, duhen ndërmarrë një sërë masash në nivel të qeverisjes vendore dhe qendrore.

**Në nivel qendror:**

- Duhet bërë një pasqyrë e qartë ku të tregohet se niveli i transfertave të pakushtëzuara (të përgjithshme dhe sektoriale) të mbetet i paprekur përgjatë 2020 dhe gjatë periudhës 2021-2023, sipas Udhëzimit të MFE-së Nr. 10/2020 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2021-2023".
- Duhen dhënë alternativa për t'i kompensuar bashkitë për humbjet që pësuan nga të ardhurat nga burimet e veta, si rrjedhojë e situatës së pandemisë, për të mundësuar ofrimin e shërbimeve vendore. Një sugjerim për shembull mund të jetë që të fillohet me ndarjen e 2% të taksës mbi të ardhurat personale (përfshi edhe kreditin e taksës së vitit 2018-2019), siç parashikohet në Ligjin Nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" dhe të rritet përqindja që bashkitë marrin nga taksat e ndara si renta minerale dhe/ose taksa vjetore e mjeteve të përdorura.
- Duhen përcaktuar rregullat fiskale për kontrollin e shpenzimeve të bashkive (si rregulla që kufizojnë rritjen vjetore të shpenzimeve operative);
- Duhet ngritur një fond i kushtëzuar për të mbuluar shpenzimet e emergjencës së shkaktuar nga COVID-19, krahas fondit të emergjencave që bashkitë planifikojnë çdo vit, i cili gjithsesi vlerësohet se është i pamjaftueshëm për t'i mbuluar këto nevoja;
- Mund të lehtësohen procedurat për rialokimin e fondeve midis zërave të ndryshëm të shpenzimeve për një periudhë të caktuar kohe, për të mundësuar ndërhyrje në kohë për plotësimin e nevojave të komuniteteve;
- Duhet lehtësuar procesi i huamarrjes në nivel vendor (në sistemin bankar vendor) për financimin e projekteve të nisura tashmë ose të reja përkundrejt përmbushjes së kushteve

të përcaktuara në Ligjin Nr. 9869/2008 "Për huamarrjen e qeverisjes vendore", për ato bashki që janë në gjendje ta mbulojnë borxhin brenda marzheve të tyre neto të operimit.

**Në nivel vendor:**

- Duhet ofruar mbështetje për bizneset e vogla dhe të mesme, duke krijuar lehtësira fiskale dhe/ose krijuar skema për grante të vogla, në mënyrë që të mundësohet rifillimi i punës dhe të shmanget sa më shumë të jetë e mundur rreziku për të shkuar drejt falimentimit. Për shembull, kjo gjë mund të zbatohet për sektorët e turizmit dhe bujqësisë, si dy sektorë tejet të goditur nga kriza, ose për sektorë të tjerë në varësi të aktiviteteve që zhvillohen në bashki të caktuara;
- Duhen siguruar burimet e nevojshme për të garantuar vijimësinë e projekteve të investimit në proces e sipër. Edhe aplikimi në mënyrë proaktive te projektet aktuale aktive të donatorëve mund të ndihmojë në këtë drejtim;
- I duhet dhënë prioritet listës së investimeve duke mundësuar zbatimin e atyre investimeve që kanë ndikim më të madh në zhvillimin e ekonomisë vendore dhe në hapjen e vendeve të reja të punës;
- Ndjekja e një qasjeje konservatore lidhur me alokimin e shpenzimeve, veçanërisht lidhur me shpenzimet aktuale, që në vitin 2015 pësuan rritje, konfirmohet edhe gjatë 2019-s (Co-PLAN, 2020). Gjithashtu, bashkitë duhet të shmangin vështirësitë aktuale financiare që mund të sjellin detyrime të prapambetura më të larta në fund të vitit.

Për ta përmbyllur, në këtë çast, bashkitë duhen nxitur nga qeveria kombëtare që të marrin në dorë situatën në qytetet e tyre përkatëse, duke përdorur një qasje proaktive dhe duke treguar nivel të lartë llogaridhënieje kundrejt qytetarëve të tyre. Krahas kësaj, qeveritë vendore nuk duhet ta pozicionojnë më veten thjesht si zbatues të udhëzimeve të lëshuara nga qeveria kombëtare. Ndonëse përgjigja ndaj emergjencës shëndetësore do të vijojë të menaxhohet në nivel qendror, bashkitë kanë të gjithë tagrin ligjor dhe moral që të marrin nën kontroll planifikimin ekonomik, social dhe territorial, për ta kaluar krizën dhe për të përgatitur institucione dhe komunitete vendore të afta për t'u ripërtërirë, me qëllim menaxhimin efikas të fatkeqësive në të ardhmen. Sigurisht që drejtimi në nivel vendor dhe sistemi i qeverisjes shumënivelëshe të territorit, ku qytetarët angazhohen në masë krah për krah qeverive vendore është jetik për suksesin e mundësimit të aftësisë ripërtëritëse në nivel vendor.

# 5. Shtojcat

## 5.1 Pyetësori

SHOQATA PËR AUTONOMINË VENDORE

Co-PLAN

**PYETËSOR**

**Roli, sfidat dhe nevojat e bashkive dhe aktorëve në nivel vendor gjatë krizës COVID-19**

**REALIZUAR nga**

**Shoqata për Autonominë Vendore dhe Co-PLAN Instituti për Zhvillimin e Habitatit**

**Prill 2020**

**Sfondi i Anketës:**

Gjatë periudhës Mars – Prill 2020, Shqipëria, sikurse edhe vende të tjera Evropiane, është prekur nga pandemia COVID-19. Prekja nga coronavirusi i ri është shtrirë në të gjithë territorin, duke vënë në vështirësi sistemin shëndetësor dhe atë të mbrojtjes civile. Ndërkohë, masat e marra nga qeveria për vendosjen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore, karantinimin dhe kufizimin e disa lirive individuale, janë instrumenti i përdorur për të ulur kurbën e infektimit, transmetueshmërinë dhe presionin mbi shërbimin spitalor. Në këto kushte, roli i pushtetit vendor dhe i aktorëve lokalë për të ndihmuar në zgjidhjen e krizës mbetet i kufizuar, por jo i pamundur.

Pyetësori në vijim, i realizuar nga Shoqata e Autonomisë Vendore në bashkëpunim me Co-PLAN, synon të mbledhë informacion mbi rolin aktual dhe të ardhshëm të aktorëve publikë dhe jo-publikë në nivel vendor, për të adresuar krizën që shoqëron pandeminë COVID-19, përfshirë sfidat me të cilat përballen këta aktorë dhe nevojat e tyre.

Studime të ngjashme po realizohen në vende të ndryshme, për të kuptuar rolin e mundshëm, forcën dhe aftësinë, si edhe sfidat e nivelit vendor për të adresuar dhe zbutur krizat e fatkeqësive. Ndërkohë që niveli vendor është shumë më afër qytetarëve sesa ai qendror dhe ka aftësi reagimi të shpejta, jo kudo ai përgjigjet në mënyrë të njëjtë, për shkak të kompetencave të kufizuara, mungesës në burime njerëzore dhe financiare, hendeqeve ligjore, mungesës së trajnimit dhe të grupeve vullnetare, etj.

Përgjigjet e dhëna në këtë pyetësor do të përpunohen dhe rezultatet e nxjerra do të përdoren për të ndikuar politikëbërjen dhe procesin e decentralizimit në lidhje me adresimin e krizave të fatkeqësive, për të ndihmuar në forcimin e sistemit të mbrojtjes civile në nivel vendor, dhe për të advokuar në emër të pushtetit vendor për rolin dhe nevojat e aktorëve lokalë në menaxhimin e krizave.

**Emri i bashkisë:** _____

**Data e plotësimit të pyetësorit:** _____

***Shënim:*** *Ju lutem, plotësojeni pyetësorin në word. Nëse nevojitet, mund të shtoni rreshta në tabela. Pyetësorin e plotësuar dërgojeni* ***me e-mail brenda datës 30 prill 2020 në adresën elektronike****:* ***adelina.farrici@shav.al***

*Në rast se nuk mundeni ta nisni pyetësorin e plotësuar në mënyrë elektronike, atëherë, Ju lutem ta postoni në adresën:*
***Shoqata për Autonomi Vendore;***
***Rruga "Reshit Çollaku", Pallati 38, shkalla 2, Ap. 13/1;***

SHOQATA PËR AUTONOMINË VENDORE

Co-PLAN

*Tiranë*

## I. Pyetje të përgjithshme

**1.** A ka në bashkinë tuaj persona të prekur nga COVID_19?
(a) Po (b) Jo

**2.** Nëse po, ju lutem specifikoni numrin total të të prekurve deri në datën e plotësimit të pyetësorit:
Nr. _____

**3.** Sa prej personave të mësipërm, në dijeninë tuaj, po trajtohen:
a) Në Tiranë: _____ persona;
b) Në spitalin rajonal/të bashkisë: _____ persona;
*(specifikoni edhe emrin e spitalit nëse plotësoni këtë opsion)*
c) Në kushte shtëpie: _____ persona;
d) Nuk e kemi këtë informacion.

**4.** Listoni më poshtë emrat e njësive administrative nga të cilat vijnë të prekurit e COVID-19:
Njësitë administrative: _____
_____

## II. Pyetje mbi rolin e bashkisë dhe aktorëve të tjerë vendorë:

**5.** Gjatë periudhës Mars-Prill 2020, afërisht sa % të stafit keni pasur fizikisht në punë? _____%

**6.** Cilët sektorë kanë funksionuar rregullisht, janë pezulluar, apo zhvendosur *online* (vendosni emrat dhe shtoni rreshta sipas nevojës)?

| Sektorë që kanë funksionuar rregullisht | Sektorë që janë pezulluar | Sektorë që janë zhvendosur online |
|---|---|---|
| | | |
| | | |
| | | |
| | | |
| | | |

**7.** A jeni kontaktuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe/ose nga institucionet përgjegjëse për mbrojtjen civile në lidhje me masat për COVID-19 gjatë muajve si në tabelë dhe cili ka qenë fokusi i komunikimit në secilin rast (plotësoni duke zgjedhur më shumë se një alternativë duke vendosur një kryq në kutitë e përzgjedhura)?

| Fokusi i komunikimit | Ministria e Shëndetësisë | | | | Mbrojtja Civile | | | | Tjetër (kush) ---------- | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Muajt | J | Sh | M | P | J | Sh | M | P | J | Sh | M | P |
| a) Ndarje informacioni mbi gjendjen para & gjatë krizës | | | | | | | | | | | | |
| b) Informim mbi masat e nivelit qendror | | | | | | | | | | | | |
| c) Kërkesë për informacion mbi të prekurit | | | | | | | | | | | | |
| d) Kërkesë informacioni mbi banorët vulnerabël | | | | | | | | | | | | |
| e) Udhëzime për detyrat e bashkisë gjatë krizës | | | | | | | | | | | | |
| f) Udhëzime në lidhje me taksat vendore | | | | | | | | | | | | |
| g) Udhëzime mbi trajtimin e ndihmës ekonomike | | | | | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| h) Udhëzime për shpërndarje të ushqimit | | | | | | | | | | | | |
| i) Bashkëpunim për ngritjen e grupeve vullnetare | | | | | | | | | | | | |
| j) Bashkëpunim për transportin e të prekurve | | | | | | | | | | | | |
| k) Bashkëpunim për ruajtjen e rendit e qetësisë | | | | | | | | | | | | |
| l) Udhëzime në lidhje me ofrimin e shërbimeve | | | | | | | | | | | | |
| m) Tjetër (specifiko) | | | | | | | | | | | | |

*J – Janar; Sh – Shkurt; M – Mars; P – Prill; Banorë vulnerabël – të gjitha kategoritë që nuk kanë të ardhura, marrin ndihmë ekonomikë, janë të moshuar që jetojnë vetëm dhe nuk lëvizin dot nga shtëpia për shkak të kufizimeve, gjendjes shëndetësore, prindër të vetëm me fëmijë, etj.*

**8.** Nëse keni luajtur apo luani rol në lidhje me menaxhimin e krizës brenda territorit të bashkisë, sipas udhëzimeve të marra nga institucionet qendrore, ju lutem shpjegoni shkurtimisht për çfarë bëhet fjalë.

| **1. Masa të ndërmarra** | **2. Shpjegimi** |
|---|---|
| a) Identifikimi i grupeve në nevojë | |
| b) Furnizimit dhe shpërndarja e ushqimeve | |
| c) Dezinfektimi i rrugëve dhe hapësirave publike | |
| d) Kontrolli përmes policisë bashkiake i lëvizjes së qytetarëve sipas orareve | |
| e) Kontrolli dhe monitorimi i tregjeve dhe njësive tregtare për distancat mes njerëzve dhe mënjanimin e tejmbushjes | |
| f) Identifikimi dhe raportimi për raste potenciale të të prekurve | |
| g) Transporti i të prekurve në Tiranë në ndihmë të institucioneve qendrore | |
| h) Monitorim për banorë vulnerabël ose të prekur në zonat që rrezikohen nga risku i fatkeqësive të tjera natyrore si, rrëshqitje dheu, përmbytje, etj. | |
| i) Tjetër (specifiko) | |

**9.** Masat që keni marrë për menaxhimin e krizës, a i keni përgatitur përmes një plani pune ose një strategji me veprime konkrete për menaxhimin e krizës?

(a) Po (b) Jo

**10.** A e keni miratuar planin e punës ose strategjinë në këshill bashkiak?

(a) Po (b) Jo

**11.** A është koordinuar strategjia/plani i punës me Zyrën e Emergjencave Civile pranë Prefekturës?

(a) Po (b) Jo

**12.** A është koordinuar/konsultuar strategjia/plani i punës me Agjencinë Kombëtare të Emergjencave Civile ose institucione të tjera në nivel kombëtar?

(a) Po (b) Jo

**13.** A është bërë strategjia publike dhe e aksesueshme për qytetarët?

(a) Po (b) Jo

**14.** A kryeni dezinfektime në territor dhe ndërtesa?

(a) Po (b) Jo

**15.** Nëse përgjigja për pyetjen 14 është po, cilat prej ndërtesave të listuara janë dezinfektuar dhe sa për qind ndaj totalit të ndërtesave për çdo kategori si në vijim?

| **Godina/territore** | **A janë dezinfektuar?** | **Sa % ndaj totalit janë dezinfektuar?** |
|---|---|---|
| a) Zyrat e bashkisë | Po Jo | |
| b) Kopshte | Po Jo | |
| c) Çerdhe | Po Jo | |
| d) Shkolla 9-vjeçare | Po Jo | |
| e) Shkolla profesionale | Po Jo | |
| f) Qendra shëndetësore | Po Jo | |
| g) Ndërtesa ku janë identifikuar persona me COVID | Po Jo | |
| h) Rrugë dhe trotuare | Po Jo | |
| i) Parqe dhe lulishte | Po Jo | |
| j) Kënde lojërash | Po Jo | |
| k) Muze | Po Jo | |
| l) Biblioteka | Po Jo | |
| m) Tjetër_____ | Po Jo | |

**16.** Nëse keni shpërndarë / po shpërndani ushqime tek banorët vulnerabël, ju lutem shpjegoni:

| **Pyetjet** | **Përgjigjet** |
|---|---|
| a) Kategoritë e banorëve vulnerabël të cilëve u keni shërbyer | |
| b) Emrat e njësive administrative ku keni shpërndarë ushqime | |
| c) Sa here në javë keni shpërndarë ushqime | |
| d) Sa javë ka vazhduar procesi i shpërndarjes së ushqimeve? | |
| e) Në sa % të familjeve të ndihmuara keni dërguar ushqime më shumë se 1 herë? | |
| f) Çështje të tjera të rëndësishme që lidhen me këtë detyrë të bashkisë | |

**17.** A është ngritur një grup vullnetarësh pranë bashkisë për menaxhimin lokal të situatës së COVID-19?

(a) Po (b) Jo

**18.** Nëse po, Ju lutem shpjegoni si në vijim:

| **Çështjet** | **Shpjegimi** |
|---|---|
| a) Numri i vullnetarëve | |
| b) Mosha mesatare e vullnetarëve | |

| | |
|---|---|
| c) Roli i vullnetarëve | |
| d) Njësitë administrative ku janë angazhuar vullnetarët | |
| e) Kategoritë e grupeve në nevojë që ndihmohen nga vullnetarët | |
| f) Oraret ditore dhe javore gjatë të cilave punojnë vullnetarët | |
| g) Lloji i ndihmës që japin vullnetarët | |
| h) Nëse grupi i vullnetarëve është ngritur nga bashkia, shpjegoni kur u ngrit dhe a është krijuar me një vendim të këshillit bashkiak? | |
| i) Nëse grupi i vullnetarëve është ngritur në mënyra të tjera (angazhim i pavarur qytetar apo me ndihmën e një projekti nga shoqëria civile dhe donatorët), ju lutëm shpjegoni rastin. | |

**19.** Në dijeninë tuaj, a ka iniciativa qytetare, të shoqërisë civile apo të bizneseve lokale që ofrojnë ndihmë për menaxhimin e krizës?

(a) Po (b) Jo

**20.** Nëse përgjigja e pyetjes 19 është po, Ju lutem përshkruani shkurtimisht iniciativat duke plotësuar karakteristikat në tabelat në vijim (shtoni tabela nëse ka më shumë se tre iniciativa):

| **RASTI 1._____** | **Shpjegimi** |
|---|---|
| Kush është angazhuar? | |
| Çfarë ofron? | |
| Me çfarë frekuence kohore? | |
| Cilat grupe shoqërore ndihmon? | |
| Përshkruani si e ofron ndihmën | |
| Përshkruani si bashkëpunon me bashkinë | |

| **RASTI 2._____** | **Shpjegimi** |
|---|---|
| Kush është angazhuar? | |
| Çfarë ofron? | |
| Me çfarë frekuence kohore? | |
| Cilat grupe shoqërore ndihmon? | |
| Përshkruani si e ofron ndihmën | |
| Përshkruani si bashkëpunon me bashkinë | |

| **RASTI 3._____** | **Shpjegimi** |
|---|---|
| Kush është angazhuar? | |
| Çfarë ofron? | |
| Me çfarë frekuence kohore? | |

| | |
|---|---|
| Cilat grupe shoqërore ndihmon? | |
| Përshkruani si e ofron ndihmën | |
| Përshkruani si bashkëpunon me bashkinë | |

**21.** Përveç Ministrisë së Shëndetësisë dhe institucioneve të Mbrojtjes Civile, me cilat institucione të tjera në nivel qendror dhe vendor po punoni dhe bashkëpunoni konkretisht për menaxhimin e krizës në territorin e bashkisë tuaj (vendosni emrat dhe shtoni rreshta sipas nevojës):

| **Institucione në nivel vendor** | **Institucione në nivel qendror** |
|---|---|
| | |
| | |
| | |

## III. Pyetje mbi sfidat dhe nevojat e bashkisë dhe aktorëve të tjerë vendorë:

**22.** Nëse keni pasur vështirësi në ofrimin e shërbimeve publike gjatë periudhës Mars – Prill 2020, atëherë ju lutem shpjegoni shkurtimisht se çfarë:

| **1. Shërbimi** | **2. Shpjegimi i problemeve*** |
|---|---|
| a) Largimi i mbetjeve | |
| b) Furnizimi me ujë të pijshëm | |
| c) Mirëmbajtja e sistemit të kanalizimeve dhe trajtimi u ujërave të ndotura | |
| d) Mirëmbajtja e rrugëve | |
| e) Dhënia e lejeve të ndërtimit | |
| f) Mirëmbajtja e infrastrukturës për ujërat e larta | |
| g) Mirëmbajtja dhe funksionimi i tregjeve | |
| h) Promovimi i zhvillimit ekonomik vendor | |
| i) Mbrojtja civile (të gjitha aspektet e tjera veç pandemisë) | |
| j) Transporti publik | |
| k) Mirëmbajtja e sistemit të kullimit dhe vaditjes | |
| l) Shërbime administrative për qytetarët e bizneset | |
| m) Monitorimi dhe mbrojtja e mjedisit | |
| n) Menaxhimi i pyjeve dhe kullotave | |
| o) Aktivitete kulturore dhe mbrojtja e trashëgimisë | |
| p) Ofrimi i shërbimeve sociale | |
| q) Vijimi i punës për trajtimin e impaktit të tërmetit të 26 nëntor 2019. | |

**Ju lutem rendisni të gjithë gamën e mundshme të problemeve, nisur nga vështirësitë për të lëvizur, stafi i kufizuar për të mundësuar distancimin social, tarifat dhe/ose taksat e pa-mbledhura, aksesi i kufizuar ose i ulur në burimet financiare, ndërprerja e punimeve nga kontraktorët, pakënaqësia sociale, vështirësitë e biznesit, mungesa e komunikimit me qytetarët, pamundësia për të ofruar shërbimet on-line, etj. – shtoni dhe shpjegoni sipas rastit dhe praktikës tuaj.*

**23.** A keni bërë rishikime në buxhetin e vitit 2020 në funksion të përballimit të situatës të shkaktuar nga COVID-19?

(a) Po (b) Jo

**24.** Nëse përgjigja e pyetjes 23 është po, atëherë Ju lutem specifikoni ndryshimet e bëra duke përmendur përdorimin:

- _____
- _____
- _____
- _____
- _____
- _____

**25.** A keni bërë rishikime në paketën fiskale të vitit 2020 në funksion të përballimit të situatës të shkaktuar nga COVID-19?

(a) Po (b) Jo

**26.** Nëse përgjigja e pyetjes 25 është po, atëherë Ju lutem specifikoni ndryshimet:

- _____
- _____
- _____
- _____
- _____

**27.** Sa % të planit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore mendoni do të realizoni në katër-mujorin e parë të vitit 2020? _____%.

**28.** A parashikoni të keni probleme në arkëtimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore në 4-mujorin e parë të vitit 2020 *(qarko po ose jo)* dhe cilat mund të jenë arsyet *(vendos kryq në alternativën e zgjedhur)*?

| Taksa/Tarifa<br>**nëse ju aplikoni tarifë shërbimesh (pastrim, gjelbërim dhe ndriçim), jepni të njëjtat përgjigje në tarifat a, b, dhe c.* | Probleme në arkëtim | Arësyet e problemeve në arkëtim | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Familjarët | | | Biznesi | | |
| | | Nuk dalin nga banesa | Mendojnë se nuk kanë marrë shërbime | Nuk përdorin pagesat on-line | Janë mbyllur dhe nuk pranojnë të paguajnë | Kanë vështirësi me pagesat online | Tjetër_____ |
| a) Tarifa e pastrimit dhe higjienës | Po Jo | | | | | | |
| b) Tarifa e gjelbërimit | Po Jo | | | | | | |
| c) Tarifa e ndriçimit publik | Po Jo | | | | | | |
| d) Tarifa për përdorimin e hapësirave publike | Po Jo | | | | | | |
| e) Taksa e përkohshme për infrastrukturën arsimore | Po Jo | | | | | | |
| f) Taksa e ndërtesës | Po Jo | | | | | | |
| g) Taksa e truallit | Po Jo | | | | | | |
| h) Taksa e tokës bujqësore | Po Jo | | | | | | |
| i) Taksa e hotelit | Po Jo | | | | | | |
| j) Taksa e tabelës | Po Jo | | | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| k) Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël | Po Jo | | | | | | |
| l) Tjetër_____ | Po Jo | | | | | | |

**29.** Në lidhje me sfidat me shpërndarjen e ushqimeve tek banorët vulnerabël, shënoni me kryq cilat nga çështjet aplikohen dhe vlerësoni vetëm ato që aplikohen (përgjigja është "po") në një shkallë nga 1 – më pak e rëndësishme në 5 – shumë e rëndësishme.

| **Sfida:** | **Aplikohet** | **Vlerësimi 1 - 5** |
|---|---|---|
| a) Identifikimi i banorëve vulnerabël ka qenë i vështirë dhe ne kemi mundur ta realizojmë vetëm për banorët në listat e ndihmës ekonomike. | Po Jo | |
| b) Burimet financiare për të siguruar ushqime për banorët vulnerabël kanë qenë të pamjaftueshme për të gjithë të identifikuarit. | Po Jo | |
| c) Nuk ka pasur furnizime të mjaftueshme në treg. | Po Jo | |
| d) *Transporti i ushqimeve ka qenë i vështirë për shkak të *(zgjidhni të gjitha ato që aplikohen):* | Po Jo | |
| i) terrenit | Po Jo | |
| ii) motit | Po Jo | |
| iii) kufizimeve në lëvizje dhe oraret | Po Jo | |
| iv) mungesës së mjeteve të transportit | Po Jo | |
| v) pamjaftueshmërisë së stafit për të realizuar funksionin | Po Jo | |
| e) Tjetër (specifiko) | Po Jo | |

**Për pikën d), pasi ta vlerësoni si çështje – nëse e zgjidhni, ju lutem rinumëroni rëndësinë sipas shkallës 1-5 me po të njëjtën llogjikë vlerësimi edhe për nën-çështjet. Për çështje apo nën-çështje që nuk aplikohen në bashkinë tuaj, ju lutem mos vendosni vlerësim.*

**30.** Përmendni, shpjegoni dhe rendisni sipas rëndësisë, sfida të tjera në nivel vendor si në vijim, për situatën aktuale dhe atë afatshkurtër të pritshme (plotësoni vetëm për ato që aplikohen). Sa i përket renditjes vlerësoni vetëm 5 sfidat kryesore ku 1 është sfida kryesore dhe 5 ajo më pak e rëndësishme ndër pesë të zgjedhurat):

| **Sfida:** | **Aplikohet** | **Vlerësimi 1 - 5** | **Shpjegimi dhe mundësisht shifra mbi magnitudën e problemit** |
|---|---|---|---|
| a) Pamundësia për të ndihmuar dhe bashkëpunuar me bizneset | Po Jo | | |
| b) Mosfunksionimi i shkollave profesionale dhe moskryerja e punës praktike të këtyre shkollave, me ndikim ekonomik | Po Jo | | |
| *c)* Rritja e papunësisë (*nëse zgjidhni këtë opsion ju lutem jepni edhe një shifër të përafërt ose % për personat që rrezikojnë papunësinë)* | Po Jo | | |
| d) Biznese që po mbyllen (*nëse zgjidhni këtë opsion ju lutem jepni edhe një shifër të përafërt ose % për bizneset që mbyllen dhe tipologjinë e tyre).* | Po Jo | | |
| e) Mosfunksionimi i sektorit të | Po Jo | | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| turizmit – sezonet e 2020 dhe ndoshta 2021 | | | |
| f) Rënie aktuale dhe e pritshme e nivelit të taksave për të gjithë periudhën mars – dhjetor 2020 | Po Jo | | |
| g) Rritje e pritshme e familjeve që do të kërkojnë ndihmë ekonomike | Po Jo | | |
| h) Rritje e nivelit të varfërisë | Po Jo | | |
| i) Probleme me kontratat për transportin publik të pezulluar gjatë karantinimit | Po Jo | | |
| j) Probleme me kontrata të tjera për shërbimet publike (cilat konkretisht) | Po Jo | | |
| k) Pamundësi për të ofruar shërbime për të dëmtuarit pas tërmetit të 26 nëntorit 2019 | Po Jo | | |
| l) Rënie e nivelit të të ardhurave vendore për 2020 dhe 2021 *(shpjegoni konkretisht çfarë, si dhe në çfarë vlerash apo % prisni të ketë rënie)* | Po Jo | | |
| m) Emigrantë të kthyer që kanë mbetur në Shqipëri dhe nuk mund të kthehen pas në shtëpitë e tyre | Po Jo | | |
| n) Pamundësia për të përfituar nga programet aktuale të zhvillimit të mbështetura nga donatorët, për shkak të vështirësive në zbatim, të krijuara nga kriza | Po Jo | | |
| o) Tjetër (specifikoni) | Po Jo | | |

**31.** Rendisni tre-pesë nevojat kryesore që ju keni si pasojë e krizës COVID-19 dhe që do të donit të plotësonit për ta përballuar krizën aktuale (shëndetësore, sociale dhe ekonomike) në nivel vendor përgjatë periudhës prill - dhjetor 2020 dhe gjatë vitit 2021.

- _____
- _____
- _____
- _____
- _____

## 5.2 Nevojat e qeverive vendore

*Tabela 3.* Nevojat e bashkive 2020-2021

| | Nevoja 1 | Nevoja 2 | Nevoja 3 | Nevoja 4 | Nevoja 5 |
|---|---|---|---|---|---|
| Lushnje | Paketa ushqimore | Rritja e papunësisë | Mbyllja e biznesit | | |
| Devoll | Plotësimi detyrimit ligjor për transfertën e kushtëzuar për mbrojtjen civile nga qeveria (2.3% e buxhetit për emergjencat civile) | Rritje e transfertës se pakushtëzuar | Rritje PAK & NE | | |
| Berat | Rishikim Buxheti | Mobilizim profesioniste | Forcimi grupeve vullnetare | | |
| Cërrik | Rritja e papunësisë | Rritje e familjeve qe kërkojnë NE | Rritje e nivelit te varfërisë | Rënie e nivelit të të ardhurave | |
| Durrës | Rritje PAK & NE | Mbështetje për bizneset e vogla | Asistence shëndetësore për personelin ne institucione publike | Asistence shëndetësore grupet vulnerabël | Ngritja e shërbimeve lëvizëse |
| Elbasan | Rënie e nivelit të të ardhurave | Ndërgjegjësimi i banoreve për sjelljen ne tregje | Rritje e fondeve për menaxhimin e situatës sidomos për grupet vulnerabël | Ndërgjegjësimi i moshës se trete për tu izoluar | |
| Fier | Nevoja për fonde për kryerjen e investimeve dhe ofrimin e shërbimeve publike | Plotësimi i legjislacionit për Turizmin ne situate COVID | Rishikim i Urdhrave të Ministrisë së Financave për funksionimin e pagesave në Thesar, me qëllim mos krijimin e detyrimeve të prapambetura. | Shtesë fondi për krijimin e qendrave të evakuimit të popullatës në rast fatkeqësie natyrore | |
| Finiq | Rritje fondesh për NE dhe furnizim me ushqime te familjeve ne nevoje | Shtesë fondi për ngritjen e infrastrukturës së komunikimit virtual për dhënien e shërbimeve online; | Shtesë fondi për përmirësimin e infrastrukturës së qendrave shëndetësore dhe krijimin e Urgjencës Spitalore në qendër të bashkisë | | |
| Gramsh | Rritje e fondeve për emergjencat | Burime financiare për të siguruar ushqime për familjet vulnerabël; | Burime financiare për të kryer dezinfektim më efektiv në të gjithë territorin e bashkisë Gramsh. | | |
| Këlcyrë | Ndihma ushqimore për familjet në nevojë | Ndihme financiare ose kreditim të bute për fermerët shoqëruar me projekte konkrete për zhvillimin e fermave te tyre me prodhimet e vendit; | Gjetjen e donatoreve te mundshëm për rikonstruksion te shtëpive te personave vulnerabël me qellim përmirësimin e kushteve te tyre te jetesës | | |
| Klos | Rritje fondesh për NE dhe furnizim me ushqime te familjeve ne nevoje | Rritje e transfertës se pakushtëzuar | Shtesë personeli për shërbimet sociale (psikologe) | Furnizime për qendrat shëndetësore | |
| Kolonje | Rritje e fondeve për emergjencat | Mbështetje me maska, doreza, dezinfektues | Subvencione për bizneset, turizmin dhe argotizmin. | | |
| Konispol | Rritje e fondeve për shtresat në nevojë | Mbështetje për plotësimin e detyrimit për dezinfektimin e ambienteve publike | | | |
| Korce | Rënie e ndjeshme e të ardhurave nga burime vendore | Shtesë fondesh nga QQ | | | |
| Kuçovë | Kompensim për nivelin më të ulët të të ardhurave vendore në vijim të lehtësive fiskale vendore të ndërmarra | Mbështetje për investimet prioritare dhe krijim vende pune | Mbështetje financiare për projekte sociale qe do mund te ndikojnë ne uljen e varfërisë | | |
| Kurbin | Hapja e bizneseve te vogla dhe të vetë punësuarit | | | | |
| Libohovë | Plotësimi detyrimit ligjor për transfertën e kushtëzuar për mbrojtjen civile nga | Ritje e fondeve për shtresat në nevojë | Pajisja me maska, doreza, dezinfektonte | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | për emergjencat civile) | | | | |
| Librazhd | Rritje e fondeve për shtresat në nevojë | Plotësim nevoja me mjete transporti dhe logjistika | Pajisja me maska, doreza, dezinfektonte | Rritje e transfertës se pakushtëzuar | |
| Maliq | Plotësimi detyrimit ligjor për transfertën e kushtëzuar për mbrojtjen civile nga qeveria (2.3% e buxhetit për emergjencat civile) | Rritje e fondeve për shtresat në nevojë | Rritje e transfertës së pakushtëzuar | Mbështetje për bizneset në sektorin bujqësor | |
| Mat | Plotësimi detyrimit ligjor për transfertën e kushtëzuar për mbrojtjen civile nga qeveria (2.3% e buxhetit për emergjencat civile) | Rritje e fondeve për shtresat në nevojë | Rritje e transfertës së pakushtëzuar | | |
| Patos | Rritje e fondeve për shtresat në nevojë | Rritje e fondeve për grupet e veçanta për viktimat e dhunës dhe fëmijët në nevojë | Rritje e transfertës së pakushtëzuar | Rishikim i paketës fiskale | |
| Peqin | Rritje e fondeve për shtresat në nevojë | Rritje e transfertës se pakushtëzuar | | | |
| Përmet | Plotësimi detyrimit ligjor për transfertën e kushtëzuar për mbrojtjen civile nga qeveria (2.3% e buxhetit për emergjencat civile) | Rritje e fondeve për shtresat në nevojë | Rritje e transfertës së pakushtëzuar | | |
| Poliçan | Rritje e transfertës se pakushtëzuar | Rimbursim nga qeveria qendrore për shpenzimet e paparashikuara te kryera nga buxheti bashkisë | Mbështetje financiare për qendrën ditore që ofron vakte për njerëzit me nevoja specifike | Bazë materiale dhe fuqizim i qendrës shëndetësore | |
| Pukë | Plotësimi detyrimit ligjor për transfertën e kushtëzuar për mbrojtjen civile nga qeveria (2.3% e buxhetit për emergjencat civile) | Rritje e fondeve për shtresat në nevojë | Rritje e transfertës së pakushtëzuar | | |
| Selenicë | Rritje e fondit te emergjencave | Rritje e transfertës së pakushtëzuar | | | |
| Tepelenë | Rritje e fondeve për shtresat në nevojë | Rritje e transfertës së pakushtëzuar | | | |
| Tropoje | Rritje e fondeve për shtresat në nevojë | Shtesë personeli për shërbimet sociale (psikologe) | Rritje e transfertës së pakushtëzuar | | |
| Ura Vajgurore | Mbështetje e biznesit nëpërmjet paketave të qeverisë qendrore | | | | |
| Vau Dejës | Mungesë fondesh për përballimin e krizës së Covid-19 | Hapja e tregut lokal (sipas specifikimeve (sinjalistikë, orare) | | | |
| Vorë | Plotësimi detyrimit ligjor për transfertën e kushtëzuar për mbrojtjen civile nga qeveria (2.3% e buxhetit për emergjencat civile) | Rritje e transfertës së pakushtëzuar | Nevoja për më shumë ndihma ushqimorë | | |
| Malësi e Madhe | Mbështetje e bizneseve te vogla ne fushën e shërbimeve, turizmit | Mbështetje për fermerët (shitje e produktit) | Mbështetje financiare për familjet në nevojë | | |
| Bulqizë | Mbështetje financiare për te papunët si pasoje e COVID-19 | Mbështetje për shtresën vulnerabël të popullsisë | Mbështetje nga donatorë me projekte për investime në infrastrukture dhe jo vetëm për të rritur numrin e të punësuarve | Nxitja e prodhimeve bujqësore dhe shitja e tyre brenda Qarkut | |
| Dropull | Ndihma ushqimore për familjet ne nevoje | Ndihmë financiare apo kredi e butë për fermerët e zonës përkundrejt projekteve përkatëse | Gjetja e donatoreve te mundshëm për rikonstruksion e shtëpive te personave vulnerabël me qellim përmirësimin e kushteve te tyre te jetesës; | | |
| Memaliaj | Rritje e transfertës së pakushtëzuar | Rritje e fondeve për shtresat në nevojë | Plotësimi për transfertën e kushtëzuar për mbrojtjen civile nga qeveria | | |
| | | Plotësimi detyrimit ligjor | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Mirditë | Rritje e transfertës së pakushtëzuar | për transfertën e kushtëzuar për mbrojtjen civile nga qeveria | Rritje e fondeve për shtresat në nevojë | | |
| Roskovec | Burime financiarë për të siguruar vijimësinë e shërbimeve publike | Rritje e fondit te emergjencave | Përfshirje në paketat ndihmëse të punonjësve në të zezë | | |
| Mallakastër | Rritje e buxhetit të bashkisë | Zgjerim paketa sociale | | | |
| Tiranë | Hapja e procesit të prokurimit publik | Rritja e NE dhe subvencionit të qirasë | Tërheqja e investimeve të huaja për krijimin e vendeve të punës | | |
| Shijak | Identifikimi familjeve ne nevoje | Përcaktimi shërbimeve për secilën familje ne nevoje | Strukturimi grupeve te punës | Informimi për masat dhe shërbimet që do të ndërmarrë bashkia | |
| Kavaje | Paketa ushqimore te pamjaftueshme dhe asistencë ekonomike për personat që humbasin punën | Ndihmë në aspektin psikologjik për përballimin dhe mirëkuptimin e situatës nga qytetarët; Nevoja për mjete teknologjike për mundësimin e mësimit on-line për fëmijët në familje në nevojë | Mbështetje për bizneset e mbyllura (lehtësi) | Nevoja për mjete teknologjike për mundësimin e mësimit on-line për fëmijët në familje në nevojë | |
| Dibër | Rimbursim e fondeve nga humbjet e shkaktuara nga mos vjelja e taksave dhe tarifave vendore | Mbështetje e sektorit bujqësore me fara, fidanë, plehra; Sigurimi I tregut për produktet bujqësore (edhe për stoqet) | Mbështetje për sektorin e turizmit | Mbështetje për të papunët | Pajisja me baze materiale te nevojshme për situatën e te gjithë institucioneve shëndetësore (qendra shëndetësore) |
| Divjake | Rritje e fondit te emergjencave | Rritje e fondeve për shtresat ne nevoje | Rritje e transfertës së pakushtëzuar | | |
| Rrogozhinë | Rritje e fondeve për shtresat në nevojë | Paketa lehtësuese për bizneset e mbyllura | Shtesë personeli për shërbimet sociale (psikologe) | | |
| Skrapar | Rritje e fondit te emergjencave | Nevoje për transparencë, nevojë për kohë për t'u përgatitur për zbatimin e vendimeve të komisionit qeveritar për mbrojtjen civile (jo sot për nesër). | Hapësirë e vogël për ndërhyrje donatore vendas dhe te huaj | Mungesa e grupit vullnetar lokal | |
| Kamëz | Rritje e transfertës se pakushtëzuar | Rritje e fondit te emergjencave | Ndihma ushqimore për përballimin e emergjencës | | |
| Shkodër | Baze të dhënash ne kohe reale mbi situatën ekonomike e sociale te familjes (te papune, ne asistence, me NE nga paketat e qeverise për biznesin, nga skema covid 1 covid 2, pensioniste etj) | Pjesëmarrje e bashkive ne vendimmarrje ne a) ndihme për gjurmimin e rasteve; b) ne përcaktimin e vendimeve për mbrojtjen e parandalimin e përhapjes se covid-19 ne nivel qarku dhe nivel qendror, pjesëmarrëse ne ofrimin e zgjidhjeve dhe zbatimin e tyre. | Nevojë për transparence, nevojë për kohe për tu përgatitur për zbatimin e vendimeve te komisionit qeveritar për mbrojtjen civile (jo sot për nesër). | | |
| Lezhe | Mbështetje për familjet në nevojë | Shtesë personeli për shërbimet sociale (psikologe) | Mbështetje financiare dhe konsulencë për përballimin e Covid-19 | Lehtësim për transportin e mallrave | |

## Referenca


Alam, M., 2008. Introduction. Managing Change in Local Governance. Managing Change in Local Governance (Menaxhimi i Ndryshimit në Qeverisjen Vendore).

M. Alam & A. Nickson (botimet.) *Managing Change in Local Governance (Menaxhimi i Ndryshimit në Qeverisjen Vendore). Service: Strategies for Improvement* (Shërbimet: Strategjitë për Përmirësim) Nr. 15, 1-10. Commonwealth Secretariat (Sekretariati i Komonuelthit), Londër. Në internet: https://doi.org/10.14217/9781848598782-en. Vizituar më 29 maj 2020.

Allain-Dupre, D., 2020. The territorial impact of COVID-19: Managing the crisis across levels of government (Ndikimi territorial i COVID-19: Menaxhimi i krizës përgjatë niveleve të qeverisjes), 43.

Bell, D.M., Weisfuse, I.B., Hernandez-Avila, M., del Rio, C., Bustamante, X., dhe Rodier, G., 2009. Pandemic Influenza as 21st Century Urban Public Health Crisis (Pandemia e gripit si kriza shëndetësore urbane publike e shekullit 21) *Emerging Infectious Diseases (Sëmundjet e reja infektive)*, 15 (12), 1963–1969.

Co-PLAN, 2020. Financat Publike Vendore në Shqipëri. Raporti për gjendjen 2019. Në internet: https://drive.google.com/file/d/1yz7sDvdPIri0mle3z_3eiozf-JRQZL-p/vieë. Vizituar më 11 qershor 2020.

De La Barra, X., 2000. Fear of Epidemics: The Engine of Urban Planning (Frika nga Epidemia: Motori i Planifikimit Urban) Revista *Planning Practice & Research*, 15 (1–2), 7–16.

French, P.E., 2011. Enhancing the Legitimacy of Local Government Pandemic Influenza Planning through Transparency and Public Engagement (Përforcimi i legjitimitetit të planifikimit të pandemisë së gripit nga qeveria vendore përmes transparencës dhe angazhimit të publikut). Revista *Public Administration Review*, 71 (2), 253–264.

French, P.E. Dhe Raymond, E.S., 2009. Pandemic Influenza Planning: An Extraordinary Ethical Dilemma for Local Government Officials (Planifikimi i pandemisë së gripit: Dilemë jashtëzakonisht etike për zyrtarët e qeverive vendore) Revista *Public Administration Revieë*, 69 (5), 823–830.

Hooper, M., 2020. *Pandemics and the future of urban density: Michael Hooper on hygiene, public perception and the "urban penalty" (Pandemia dhe e ardhmja e densitetit në zonat urbane: Michael Hooper për higjienën, perceptimin publik dhe "ndëshkimin urban")* Në internet: https://www.gsd.harvard.edu/2020/04/have-we-embraced-urban-density-to-our-own-peril-michael-hooper-on-hygiene-public-perception-and-the-urban-penalty-in-a-global-pandemic/. Vizituar më 28 maj 2020.

FMN, 2020. *Bordi Drejtues i FMN-së miraton 190.5 milion dollarë amerikanë për të mbështetur Shqipërinë në luftën e saj me COVID-19.* Në internet: https://www.imf.org/en/Neës/Articles/2020/04/10/pr20148-albania-imf-executive-board-approves-us-in-emergency-support-to-combat-covid-19-pandemic. Vizituar më 27 maj 2020.

Indoreëala, H. & Waghs, S., 2020. *After the Pandemic, Will We Rethink How We Plan Our Cities? (Pas pandemisë, a do ta mendojmë edhe njëherë planifikimin e qyteteve?)* Online: https://thewire.in/urban/city-planning-pandemic. Vizituar më 29 maj 2020.

INSTAT, 2019. Vjetari Statistikor Rajonal 2018. INSTAT: Tiranë.

Jabareen, Y., 2013. Planning the resilient city: Concepts and strategies for coping with climate change and environmental risk (Planifikimi i qyteteve ripërtëritëse: Konceptet dhe strategjitë për përballimin e ndryshimit klimatik dhe riskut mjedisor) Revista *Cities*, 31, 220–229.

Marisam, J., n.d. Local Governance and Pandemics: Lessons from the 1918 Flu (Qeverisja vendore dhe Pandemia: Mësimet që na dha gripi i 1918-s) *Universiteti I Detroitit, Revista "Law Review"*, 85, 37.

Niented, P. and Shutina, D., 2020. *Tourism in Transition, the Post COVID-19 Aftermath in the Western Balkans* (Turizmi në tranzicion, periudha pas COVID-19 në Ballkanin Perëndimor) Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit.

OECD, 2020. *The COVID-19 Crisis in Albania* (Kriza e COVID-19 në Shqipëri).
Rajadhyaksha, M., 2020. *Five lessons for local governments during COVID-19* (Pesë mësimet rreth qeverive vendore gjatë COVID-19). Në internet: https://www.opml.co.uk/blog/five-lessons-for-local-governments-during-covid-19. Vizituar më 28 maj 2020.

Schwartz, J. dhe Yen, M.-Y., 2017. Toward a collaborative model of pandemic preparedness and response: Taiwan's changing approach to pandemics (Drejt modelit bashkëpunues për përgatitjen dhe reagimin ndaj pandemisë: Qasja në ndryshim e Taivanit ndaj pandemisë) *Journal of Microbiology, Immunology and Infection* (Revista e Mikrobiologjisë, Imunologjisë dhe Infeksionit) 50 (2), 125–132.

Sharifi, A., 2019. Resilient urban forms: A macro-scale analysis (Format ripërtëritëse urbane: Analizë në nivel makro) Revista *Cities*, 85, 1–14.

Sivaramakrishnan, K., 2011. The Return of Epidemics and the Politics of Global–Local Health (Kthimi i pandemisë dhe politika e shëndetit globalo-vendor) *American Journal of Public Health* (Revista Amerikanë e Shëndetit Publik), 101 (6), 1032–1041.

Tagai, G., Uzzoli, A., Koós, B., Ortega-Reig, M., dhe Alcàzar, H. del, 2017. *Inner Peripheries: national territories facing challenges of access to basic services of general interest - Annex 8. Analysis of inner peripherality in Europe* (Periferitë e brendshme: territoret kombëtare përballë sfidave lidhur me aksesin në shërbime bazë me interes të përgjithshëm - Shtojca 8. Analiza e faktorëve të brendshëm periferikë në Evropë) ESPON, Raporti Përfundimtar.

Toto, R., 2020. *Building resilience for local governments in Albania: Legal and Institutional Challenges* (Mundësimi i aftësisë ripërtëritëse së qeverive vendore në Shqipëri: Sfidat ligjore dhe institucionale) Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit.

Waller, A. dhe Chakrabarti, M., 2020. *Cities That Heal: How the Coronavirus Pandemic Could Change Urban Design* (Qytete që shërojnë: Si mund ta ndryshojë pandemia e koronavirusit projektimin urban) Në internet: https://www.wbur.org/onpoint/2020/04/28/coronavirus-pandemic-change-evolution-of-cities-and-urban-design. Vizituar më 29 maj 2020.

Banka Botërore, 2020. The-Economic-and-Social-Impact-of-COVID-19-The-Country-Notes (Ndikimi ekonomik dhe social i COVID-19, Shënimet për Vendin) *Western Balkans Regular Economic Report* (Raporti Ekonomik Periodik për Ballkanin Perëndimor), (17), 44.